

MONITORIMI I PROCESIT TË EUROINTEGRIMEVE:

TË DREJTAT THEMELORE

**KORNIZA EKZISTON, ZBATIMI
NDRYSHON, GJITHKUND NEVOJITEN
MË SHUMË PARA**

TITULLI ORIGINAL:

Следење на процесот на евроинтеграции: основни права - рамка има, имплементацијата варира, секаде се потребни повеќе пари

BOTUES:

Metamorfozis - Fondacioni për Internet dhe Shoqëri,
Rr. Apostoll Gusllarot, nr.40, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
www.metamorphosis.org.mk
info@metamorphosis.org.mk
tel/faks: +389 2 3109 325

PËR BOTUESIN:

Bardhyl Jashari (Бардил Јашари)

AUTOR:

Teofill Bllazhevski (Теофил Блажевски)

REDAKTOR:

Goran Rizaov (Горан Ризаов)

PËRKTHYES PREJ MAQEDONISHTES NË SHQIP:

Valon Abdiu

DIZAJNI:

Dushan Stojković

2022

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.7.037(497.7)"2022"(047)

BLLAZHEVSKI, Teofill

Monitorimi i procesit të eurointegritimeve [Електронски извор] : të drejtat themelore : korniza ekziston, zbatimi ndryshon, gjithkund nevojiten më shumë para / [autor Teofill Bllazhevski ; përkthyes prej maqedonishtes në shqip Valon Abdiu]. - Shkup : Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis, 2022

Начин на пристапување (URL):

<https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2022/07/monitorimi-i-procesit-te-eurointegritimeve-te-drejtat-themelore-korniza-ekziston-zbatimi-ndryshon-gjithkund-nevojiten-me-shume-para-2.pdf>.

- Превод на делото: Следење на процесот на евроинтеграции: основни права
- рамка има, имплементацијата варира, секаде се потребни повеќе пари / Теофил Блажевски.
- Текст во PDF Формат, содржи 39 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 29.09.2022. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-263-088-5

а) Основни права -- Заштита -- Македонија -- 2022 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 58229253

PËRMBAJTJA

Rreth projektit dhe metodologjisë	4
Përmbledhje	4
Korniza strategjike dhe ligjet	5
Zbatimi	6
KPMD dhe AP – dy organet kyçe për mbrojtjen e të drejtave themelore	8
Numri i parashtresave rritet edhe në vitin 2022	9
KPMD-ja ka kërkuar buxhet deri në 730 mijë euro, mirëpo ka marrë pak se 315 mijë (me rebalancin)	9
KPMD-ja konsideron se duhet të jetë një organ kundërvajtës	10
AP – numri i parashtresave, pas disa vitesh rënie, është në rritje të lehtë	11
100 vende të paplotësuara te AP sipas sistematizimit	12
Paraqitja tabore me numrin e parashtresave të pranuar/regjistruara (burimi AP)	12
Shtetit nuk sforcohet me paratë, por buxheti i AK-së ende rritet ngadalë	13
Ja çfarë thotë Zyra e AP-së për buxhetin në Raportin Vjetor për vitin 2021:	13
Kushtet e këqija në burgje mbeten një problem i pazgjidhur	14
Drejtoria për Sanksione ka një buxhet prej mbi 19,5 milionë euro, por edhe ai nuk mjafton	16
Zgjidhje e keqe e problemit të personave pa identitet	18
Kapaciteti i administratës - pengesë për realizimin e ndihmës financiare	18
Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve – më së shumti vuajnë fëmijët me aftësi të kufizuara	19
Probleme të tjera të personave me aftësi të kufizuara	20
Qendrat për mbrojtje sociale një nga problemet për të drejtat sociale	22
Përfaqësimi gjinor, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë ende sfidë!	23
Komuniteti LGBT ende përballet me shumë sfida dhe kërcënime	25
“Ligji është i mirë - transfobinë e fut në sirtar”	26
Përfshirja e romëve është e inkorporuar në mënyrë sistematike, por rezultatet janë të pamjaftueshme	27
Diskriminimi ndaj romëve është një fakt i konfirmuar - segregacion dhe racizëm	28
Përfshirja vuan nga mungesa e financimit – shumë dëshira, pak para	30
Gjuha e urrejtjes është vazhdimisht në rritje - mosndëshkimi është arsyeja kryesore	30
Nevojiten ndryshimet në kornizën ligjore	32
Politikanët si nxitës të gjuhës së urrejtjes	32
Mosndëshkimi çon në krim të urrejtjes	33
Shteti me më shumë para për gjyqësorin dhe prokurorinë, “me lugë”	35
Transparenca mund të zmbrapset	35
Reformat në sektorin mediatik në periudhën 31.3 deri më 30.6.2022	36
Vazhdon mosndëshkimi për sulmet ndaj gazetarëve	37
Transmetuesi publik ende jashtë prioriteteve të qeverisë	37
Reformat në administratën publike në periudhën 31.3 deri më 30.6.2022.	38
Ligjet asses të vijnë në Kuvend	38
Transparenca mbetet segmenti më i mirë i reformave	39
Digjitalizimi me shpejtësinë e breshkës	40

Megjithëse të drejtat dhe liritë themelore të njeriut respektohen përgjithësisht në RMV, diskriminimi strukturor ende ekziston. Madje edhe aty ku ka strategji dhe ligje, zbatimi varet nga aftësitë menaxhuese për fushat specifike sektoriale të mbuluara (fëmijët, romët, antidiskriminimi), por edhe nga financimi i gjithë kësaj. Zhvillimi i shkallës së përmbushjes së të drejtave themelore ka edhe një çmim – sipas të gjithë ekspertëve me të cilët biseduam, e kjo duhet ta kalkulohet nga pushteti ekzekutiv në buxhetet e shtetit. Politikat më të fundit buxhetore për vitin 2022 tregojnë se pushteti ekzekutiv ka sens për këto nevoja financiare, ndaj edhe pse nuk mund të thuhet se po i “shkapërderdh” paratë, gjegjësisht se “është dorëgjere”, megjithatë pak nga pak i shton burimet financiare në disa politika sektoriale që mbulojnë të drejtat themelore ose fundamentale.

Autor: Teofil Blazhevski

RRETH PROJEKTIT DHE METODOLOGJISË

Dokumenti është rezultat i një hulumtimi të kryer në kuadër të projektit **“Promovimi i llogaridhënies dhe transparencës së reformave publike”**, të cilin e zbaton Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis nga Shkupi, me mbështetjen e Fondacionit Kombëtar për Demokraci nga SHBA-të. Projekti zbatohet gjatë viteve 2021 dhe 2022.

Aktivitetet e projektit synojnë të paraqesin fakte të përkthyer në tekste gazetareske nga zhanre të ndryshme, analiza dhe konkluzione nga debatet publike për nivelin e aktiviteteve reformuese dhe arritjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në disa fusha kyçe, të cilat janë theksuar edhe në raportet e progresit të BE-së për RMV-në, në rrugën drejt integritimit në BE. Këto fusha kryesore janë: **reformat në fushën e administratës publike, gjyqësorit, të drejtave themelore të qytetarëve dhe lirisë së shprehjes/mediave.**

Në kuadër të projektit përgatiten katër raporte monitorimi (tremujore), të cilat, të udhëhequra nga një metodologji cilësore, do të vlerësojnë situatën në fushat konkrete, dhe në këtë mënyrë do të japin një pasqyrë të situatës me demokracinë në vend.

Çdo raport monitorimi trajton më hollësisht një nga katër fushat kryesore dhe ofron një përmbledhje të shkurtër të ndryshimeve në tre fushat e tjera. Raporti i parë i monitorimit i referohet zbatimit të reformave në sektorin e mediave. I dyti ka të bëjë me reformat në drejtësi, ndërsa i treti ka të bëjë me reformat në administratën publike. Monitorimi-raporti i fundit i referohet situatës, gjegjësisht reformave në korpusin e të drejtave fundamentale, gjegjësisht themelore të njeriut.

Metodologjia që është e rëndësishme për këtë raport mbështetet në tre shtylla: (1) hulumtimi në zyrë, (2) artikujt gazetareskë nga gazetarë dhe redaktorë në projektet mediatike të Fondacionit “Metamorfozis”, (3) intervista me ekspertë të fushës të kryera përmes fokus grupeve, të cilat janë të njohur për donatorin dhe Fondacionin “Metamorfozis”, por për shkak të dëshirës për të shmangur çdo shqetësim apo konflikt të mundshëm në fushat ku ata punojnë (për shkak se bashkëpunojnë si me organizatat qeveritare ashtu edhe me ato joqeveritare dhe mediat), ata nuk do të emërtohen edhe në këtë raport. Gjithashtu janë shfrytëzuar edhe informacionet e marra nga bisedat joformale me ekspertë të tjerë, gazetarë apo reagime publike të vërejtura gjatë vitit..

Krahas intervistave, disa nga ekspertët plotësojnë gjithashtu edhe një pyetësor anketues, ku renditen dhjetëra pyetje nga fusha, i cili ofron një krahasim të kryqëzuar - për të nxjerrë një vlerësim nga pyetësi dhe për ta krahasuar atë me vlerësimet e marra nga intervistat dhe hulumtimi në zyrë.

PËRMBLEDHJE

Të drejtat fundamentale ose themelore janë ndër më të rëndësishmet në përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara, përmes Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian dhe organizatave dhe shoqatave të tjera relevante ndërkombëtare, kurse korpusi i të drejtave themelore është i madh, me mbi 50 nën-fusha, kështu që për qëllimet e këtij raporti, jemi fokusuar në çështjet më të rëndësishme që janë aktualisht aktuale në RMV, si nga aspekti i

përmbushjes së normës, ashtu edhe nga aspekti i zbatimit. Prandaj, në përmbledhjen e raportit, mund të veçohen gjetjet e mëposhtme, deri në fund të qershorit të vitit 2022:

- Të drejtat e njeriut në RMV përgjithësisht respektohen, megjithëse në disa fusha ende vërehen raste të diskriminimit strukturor. Institucionet kompetente ndonjëherë regjistrojnë raste të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe diskriminimit edhe në vetë institucionet e pushtetit ekzekutiv.

- Korniza strategjike dhe ligjore për respektimin e të drejtave themelore në RMV është e mbuluar mirë, përgjithësisht e harmonizuar me të gjitha dispozitat kryesore ndërkombëtare, me përjashtim të segmenteve të caktuara që kanë të bëjnë me komunitetin LGBT. Megjithatë, vazhdimisht vihet në dukje nevoja për të sjellë ndryshime ligjore në disa ligje për të cilat praktika ka treguar se kanë dobësi, dhe shpeshherë ky ndryshim vonohet për arsye të ndryshme – herë nga ekzekutivi, e herë nga pushteti legjislativ.

- Zbatimi vuan, në përgjithësi, nga dy probleme – mungesa e kapaciteteve njerëzore apo infrastrukturë dhe mungesa e parave, gjegjësisht financimi i nënvlerësuar nga buxheti.

- Ekzistojnë dy organe kryesore funksionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e diskriminimit – Avokati i Popullit dhe Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kontributi i këtyre dy organeve është i ndryshëm. Zyra e Avokatit të Popullit është organ që më së shumti punon duke i vënë në dukje dhe duke i alarmuar institucionet, ndërsa Komisioni me shpejtësi parashtron edhe kërkesa për konstatimin e shkeljeve kur konstaton diskriminim që diskriminuesi nuk e eliminon.

- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, si organi shtetëror me kompetencat më të mëdha në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut ndër kategoritë më të gjera të qytetarëve, në përgjithësi i mbulon të gjitha fushat si me rregullimin ligjor ashtu edhe me zbatimin, i cili shënon përmirësim dhe progres, ndërsa sfidat më të mëdha i regjistron në sistemin e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara, personave me aftësi të kufizuara, dhunës në familje dhe dhunës ndaj fëmijëve, ku ende regjistrohet diskriminim për arsye të ndryshme të brendshme.

- Problemi me kushtet e këqija në institucionet e mbyllura, mbi të gjitha, në institucionet e paraburgimit dhe burgjet, si dhe në institucionet edukative-përmirësuese për të miturit, është ende i theksuar dhe me ritme shumë të ngadalta të përmirësimit.

- Diskriminimi dhe dhuna ndaj komunitetit LGBT janë ende të pranishme në një masë të madhe. Transfobia shprehet fuqishëm si nga përfaqësuesit e qeverisë ashtu edhe të opozitës.

- Përfshirja e romëve, megjithëse e mbuluar në mënyrë normative, vuan nga mbështetja e pamjaftueshme buxhetore dhe romët ende përballen me shembuj të diskriminimit dhe segregimit.

- Gjuha e urrejtjes (dhe krimi i urrejtjes) është një fenomen që ka një tendencë përkeqësimi dhe rritjeje në dy-tre vitet e fundit, duke përfshirë edhe vitin 2022, ndërsa arsyeja kryesore është mosndëshkimi, e jo mosnjohja dhe raportimi në institucionet kompetente.

KORNIZA STRATEGJIKE DHE LIGJET

Korniza strategjike dhe ligjore për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut mbetet në nivel të kënaqshëm. RMV-ja është nënshkruese e shumicës së dokumenteve ndërkombëtare në këtë fushë dhe ato konventa dhe marrëveshje janë ratifikuar nga Kuvendi, që mund të konstatohet se janë pjesë e së drejtës së brendshme, përmes ratifikimit, e pastaj edhe përmes zgjidhjeve të veçanta ligjore.

Dokument kryesor strategjik është [Strategjia kombëtare për zhvillimin e konceptit një shoqëri për të gjithë dhe ndërkulturalizmi](#), e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2019, dhe e cila parasheh një nga shtyllat bazë mbi të cilën do të punohet të jenë barazia dhe mosdiskriminimi si bazë për të eliminuar ndarjen në shoqërinë maqedonase, me planin e veprimit të miratuar në tetor 2019. Krahas kësaj strategjie kombëtare, në kuadër të strategjive të tjera, shumica e të cilave për zbatim janë nën kujdesin e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, vlen të veçohet Strategjia Kombëtare për Barazi dhe Mosdiskriminim, Strategjia për Barazi Gjinore, Strategjia për inkluzionin e Romët në

RMV, Strategjia Kombëtare për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe të tjera, së bashku me planet e veprimit, programet, protokollet dhe të ngjashme.. Disa nga këto strategji, siç theksuan ekspertët e fokus grupit, kanë skaduar në vitin 2021 dhe janë krijuar dokumente të reja në bazë të atyre ekzistuese. Një shembull i tillë është Strategjia për Barazinë Gjinore, vazhdimi i së cilës për periudhën 2021-2026 [ishte në lexim të dytë në Kuvendin e RMV-së](#) në prill të viti 2022, mirëpo një kontroll i kryer në qershor tregoi se ajo ende nuk ishte miratuar. Shembull i dytë është Strategjia për Përfshirjen e Romëve, e cila skadoi në vitin 2020 dhe [ishte vendosur për konsultim publik](#) në Regjistrin e Vetëm Kombëtar të Dispozitave Ligjore - ENER më 30.12.2021. Në shkurt të vitit 2022, [Qeveria e RMV-së miratoi Strategjinë për Përfshirjen e Romëve 2022-2030](#) dhe në muajin prill, në një seancë të Qeverisë, u diskutuan politikat sociale dhe ekonomike për mbështetjen e komunitetit rom në përputhje me Strategjinë.¹ Pas kësaj [u njoftua](#) se këtë vit janë ndarë 14 milionë denarë më shumë se në vitin 2021, gjegjësisht gjithsej mbi 73 milionë denarë për realizimin e përfshirjes, në mënyrë që në maj, me ribalancimin e buxhetit, shumat sërish të zvogëlohet në rreth 63 milionë ose pak më shumë se një milion euro. Megjithatë, ka edhe strategji që kanë skaduar dhe për të cilat nuk gjenden të dhëna se po përgatiten të reja, siç është Strategjia Kombëtare për Barazinë dhe Mosdiskriminimin, e cila ishte e vlefshme për periudhën 2016-2020. Si risi e fundit është njoftimi për Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila u publikua në fund të qershorit të këtij viti.

Sa i përket kornizës ligjore, Maqedonia e Veriut që në Kushtetutë i garanton të gjitha të drejtat themelore, dhe ato janë përkthyer në ligje përkatëse. Si ligj më i rëndësishëm, zbatimi i të cilit filloi në vitin 2021 dhe vazhdon edhe në vitin 2020, mund të veçohet Ligji për Mbrojtjen dhe Parandalimin e Diskriminimit i (miratuar në fund të vitit 2020) dhe formimi i Komisionit për Parandalimin e Diskriminimit (KPMD), i cili sipas këtij ligji të ri u zgjodh në mënyrë transparente në Kuvend, përmes konkursit publik. Komisioni prej shtatë anëtarësh ka një mandat për pesë vjet për katër anëtarë të saj, për tre anëtarë për tre vjet dhe me të drejtë rizgjedhjeje, ndërsa kryetari zgjidhet nga radhët e anëtarëve të komisionit për një mandat njëvjeçar. Mirëpo, Kuvendi u vonua me zgjedhjen e anëtarit të shtatë, pasi në vitin 2021 u zgjodhën gjashtë anëtarë, dhe megjithëse Komisioni ndërhyri në Kuvend deri në fund të qershorit të vitit 2022, ende nuk ka zgjedhje të anëtarit të fundit të këtij organi.

Në korrik të vitit 2021 ka hyrë në fuqi Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje, i cili konsiderohet të jetë ligji i parë që e sanksionon dhunën me bazë gjinore. Në prill të vitit 2022, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, në bashkëpunim me ministrinë e tjera dhe sektorin joqeveritar, përgatiti dhe dërgoi një raport në Këshillin e Evropës për zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit (i cili është i vlefshëm nga viti 2018 deri në vitin 2023), për zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)².

Sa i përket kornizës ligjore, risi janë Ligji për pagesën e dëmshpërblimit monetar për viktimat e krimeve të dhunshme, si dhe ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Penal, ku të cilin futet vepra penale e “përndjekjes” për të garantuar mbrojtjen e grave nga ngacmimet seksuale dhe të gjitha format e tjera të ngacmimit përmes kanaleve të komunikimit, duke përfshirë edhe internetin. Të dyja dispozitat nuk ishin miratuar deri në kohën e shkrimit të këtij raporti, megjithëse janë propozuar që në gjysmën e dytë të vitit 2021.

Për sa i përket ligjeve dhe akteve nënligjore, praktika tregon se cilat ligje kanë dobësi dhe duhet të ndryshohen. Me punën dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, tashmë ka rekomandime për plotësimin e disa paragrafëve të Ligjit për Arsimin Fillor, të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, si dhe një akt nënligjor i lidhur me këtë ligj, rekomandime për ndryshime dhe plotësime edhe në ligje të tjera që e rregullojnë fushën e të drejtave të njeriut, si dhe iniciativa për grupet e punës, të cilat duhet të propozojnë ndryshime të tjera ligjore. Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi inicion edhe plotësime në ligjin bazë të kësaj fushe, si dhe në ligje të tjera, siç është Ligji për Kundërvajtje.

1 Qeveria e RMV - 5.4.2021 - Komunikatë nga seanca e 34 (në dispozicion në <https://vlada.mk/node/28336>)

2 MPPS – 5.4.2022 – Raporti i Maqedonisë së Veriut për GREVIO të KE – (gjendet në <https://bit.ly/3McA9kl>)

ZBATIMI

Ajo që mund të nxirret si përfundim kryesor për sa i përket strategjive dhe ligjeve, definitivisht, për të gjitha fushat, jo vetëm për të drejtat themelore, është se zbatimi i dispozitave dhe dokumenteve zhvillohet me dinamika të ndryshme. Diku më mirë, diku më keq ose më e dobët dhe diku, si për shembull në mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara, madje edhe kur arrihet një shkallë e lartë e progresit, gjërat kthehen prapa. Një shembull i tillë ishte me të drejtat për mbrojtjen e personave transgjinorë, kur në vend që të miratoheshin të drejta më të larta të mbrojtjes përmes ndryshimeve në Ligjin për Evidencën Amë, propozim-ndryshimet u kthyen në Qeveri për ripërpunim dhe nuk dihet se kur dokumenti do të dërgoet sërish në Kuvend.

Sipas ekspertëve të fokus grupit, një shkallë e mirë ose e caktuar e zbatimit mund t'i atribuohet zbatimit të Ligjit për Parandalimin e Diskriminimit, parandalimit dhe zbatimit të masave për mbrojtjen e grave nga dhuna, respektimit të të drejtave të fëmijëve, sidomos të fëmijëve që janë të përkuqesur nga shteti, sepse procesi i deinstitutionalizimit tashmë është në përfundim, ndërsa aty ku ekzistojnë ende institucionet shtetërore, situata është më e keqe³, më pas me të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në kuptimin që që nga viti i kaluar për herë të parë është bërë i mundur përdorimi i asistentëve arsimor të paguar nga shteti dhe në disa fusha të tjera. Mund të thuhet se, përveç të drejtave të përmendura tashmë të personave transgjinorë, gjërat po ndryshojnë shumë ngadalë në fushat që lidhen me të drejtat e personave me nevoja të veçanta në kategori të caktuara, të drejtat e personave në institucione të mbyllura, gjuhën e urrëjtjes, ku situata është edhe më e keqe, etj.

Për atë se ku janë problemet më të mëdha, më mirë mund të shihet nga vlerësimi i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, i cili në dhjetor të vitit 2021, me rastin e Ditës Botërore të të Drejtave të Njeriut, dolën me një vlerësim në të cilin, ndër të tjera, thuhet:

Në kontekstin tonë diskriminimi strukturor është ende më i dukshëm në trajtimin e romëve, personave me aftësi të kufizuara, pakicave seksuale dhe gjinore, grave, personave në institucione të mbyllura⁴.

Në fakt, problemet themelore në zbatimin e të drejtave themelore janë konstatuar relativisht saktë në Raportin e fundit për RMV-në të KE-së, ku ndër prioritetet e shtetit për vitin 2022 janë theksuar edhe **“të drejtat e personave në paraburgim/burgim; promovimi, mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të personave nga kategoritë e cënueshme apo të marginalizuara”,** si dhe **“përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së shërbimeve në komunitet për të identifikuar fëmijët në rrezik dhe për të ofruar mbështetje të përshtatshme për kategoritë e cënueshme të fëmijëve, veçanërisht të fëmijëve viktimë të dhunës, fëmijëve romë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara”⁵.**

Se nuk mjaftojnë vetëm ligjet, flasin edhe të dhënat për sa i përket zbatimit të Ligjit për Personat e Paregjistruar në Librin Amë të të Lindurve, i miratuar që në shkurt të vitit 2020. Sipas të dhënave të kryqëzuara nga Avokati i Popullit (AP) dhe nga hulumtimet e mediave, ky ligj nuk zbatohet në praktikë ashtu siç duhet në raport me qëllimin përfundimtar. Ka të dhëna të ndryshme për atë se sa persona janë regjistruar si persona pa dokumente. Përveç faktit se AP konstatoi se 60 për qind e atyre personave janë fëmijë dhe se autoritetet nuk kanë të dhëna të sakta se sa fëmijë janë paraqitur si të porsalindur pas skadimit të afatit, një tjetër hulumtim gazetaresk zbuloi se edhe nga ata që u paraqitën, mbi 300, dhe të cilët kanë marrë numër të përkohshëm amë dhe dokument se janë të regjistruar në Librin e Përkohshëm të Evidencës Amë, me atë dokument nuk mund të ushtrojnë asnjë të drejtë, nga hapja e llogarive bankare deri te aplikimi për ndihmë të përkohshme financiare në bazë të statusit si person i rrezikuar social ose në shërbime shëndetësore dhe arsimore, sepse institucionet nuk ua njohin ato dokumente. Në hulumtimin gazetaresk të “360 gradë” u dëshmuar se institucionet nuk bashkëpunojnë për ta zgjidhur problemin, i cili qëndron edhe në ligjin e pasaktë edhe në lidhje me atë se cilat dokumente nevojiten për zgjidhjen e problemit të personave fantazmë në mënyrë që ata të të jenë të dukshëm për sistemin⁶.

3 Nëna dhe fëmija – 6/4/2021 – Pas demantit... - (gjendet në <https://bit.ly/3r6eGBf>)

4 KHDNJ – 10.12.2021 – Përpjekja për barazi duhet të ekzistojë – (gjendet në <https://mhc.org.mk/news/streme-zhot-kon-ednakvosta-mora-da-opstoi/>)

5 SÇE - Raporti i KE-së për RMV-në për vitin 2021 – 16.10.2021 – (gjendet në <https://www.sep.gov.mk/data/file/Pregovori/North-Macedonia-Report-2021-MK2.pdf>)

6 360 gradë – 18.4.2022 - Problem me personat fantazmë – (nga minuta e 17 në video) – (në dispozicion në <https://www.youtube.com/watch?v=cp3NVM2xQcl>)

Ky hulumtim tregoi se problem mund të jetë edhe cilësia e zgjidhjes ligjore, sepse në mënyrë të pamohueshme u vërtetua se ligji nuk është plotësisht i saktë. Një shembull i ngjashëm është gjetur edhe nga Zyra e AP, pasi në raportin e fundit vjetor për punën e tij, ata vënë në dukje problemet që dalin nga Ligji i fundit për Mbrojtje Sociale i vitit 2019, që çuan në uljen e numrit të përfituesve të ndihmës financiare nga shteti pikërisht për shkak të zgjidhjeve ligjore të pazbatueshme.

Për zbatimin efikas të disa ligjeve që i referohen të drejtave themelore janë edhe financat. Për shembull, nëse shihet Raporti “Maqedonia e Veriut drejtuar ekspertëve të Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, mund të konstatohet se në total, për me atë që qëllim sigurohen jo më shumë se 200.000 euro në vit - për përkrahje për qendrat për mbrojtje sociale, për qendrat strehimore dhe për linjat telefonike SOS, për organizatat qytetare që merren me këtë problem, për kujdesin shëndetësor të viktimave, kurse shumica e përmendur përfshin edhe zërin më të madh prej 5 milionë denarësh ose 80 mijë euro në vit për ndihmë juridike falas, nga e cila, për shembull, në vitin 2020 janë shfrytëzuar vetëm rreth 25 mijë euro⁷.

Problemi i financimit të pamjaftueshëm mund të haset edhe me përfshirjen e romëve, si dhe te institucionet e Avokatit të Popullit (AP) dhe Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Diskriminimit (KPMĐ), megjithëse këtë vit paratë për mbështetje janë rritur në të dy institucionet. Mjetet fillestare me buxhetin e vitit 2022, me rebalancin e buxhetit të dorëzuar në Kuvend në fund të majit të vitit 2022, edhe pse jo në mënyrë drastike, megjithatë janë rritur, por nën presion të fortë, sidomos për KPMĐ-në.

Përfundimi do të ishte se edhe aty ku ka strategji dhe ligje, zbatimi varet nga aftësitë menaxhuese për fushat specifike sektoriale të mbuluara (fëmijët, romët, antidiskriminimi), por edhe nga financimi i gjithë kësaj. Zhvillimi i drejtave themelore ka edhe një çmim – sipas të gjithë ekspertëve me të cilët biseduam, e kjo duhet ta kalkulohet nga pushteti ekzekutiv në buxhetet e shtetit. Politikat më të fundit buxhetore për vitin 2022 tregojnë se pushteti ekzekutiv ka sens për këto nevoja financiare, ndaj edhe pse nuk mund të thuhet se po i “shkapërderdh” paratë, gjegjësisht se “është dorëgjere”, megjithatë pak nga pak i shton burimet financiare në disa politika sektoriale që mbulojnë të drejtat themelore ose fundamentale.

KPMĐ DHE AP – DY ORGANET KYÇE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE THEMELORE

Shtyllat kryesore institucionale për mbrojtjen operacionale të të drejtave themelore të njeriut, duke përfshirë parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, në vend janë dy institucione - Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMĐ) dhe Avokati i Popullit (AP).

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMĐ) me përbërjen e re është formuar vitin e kaluar (2021), në bazë të Ligjit të ri për Parandalimin e Diskriminimit të miratuar në vitin 2020. Komisioni prej shtatë anëtarësh (përkatesisht 6, sepse një nuk është zgjedhur ende) ka kompetenca dukshëm të gjera që i janë dhënë me ligj, por edhe një sfidë se si ta zbatojë atë shpejt dhe pa mbështetjen e plotë të shtetit, megjithëse vetë KPMĐ-ja e pranon se ka marrë ndihmë gjatë këtij viti si nga shteti ashtu edhe nga OSBE-ja dhe nga sektori i OJQ-ve, përmes Programit Britanik për Mbështetje dhe Zhvillim. Në vitin 2022 u lëshua në funksion edhe faqja e internetit e Komisionit, e cila bëri të mundur parashtrimin më të lehtë të parashtrësve elektronike (<https://kszd.mk/>), por së bashku me faqen e profilit në Facebook mundëson edhe komunikim më të gjerë me publikun.

Duke i parë arritjet njëvjeçare të Komisionit, mund të konstatohet se ky organ që sipas përkufizimit është i pavarur, e arsyei plotësisht besimin e publikut dhe kompetencat e mëdha që ia jep ligji, e për të cilën më meritorë është mënyra e zgjedhjes së Komisionit përmes një debati të hapur parlamentar dhe prezantimi publik i programeve dhe i aftësive të kandidatëve të atëhershëm, anëtarë të tanishëm të Komisionit.

7 MPPS – 5.4.2022 – Raporti i Maqedonisë së Veriut për GREVIO të KE – fq.11-(gjendet në <https://bit.ly/3McA9kl>)

Sipas statistikave të paraqitura në Raportin Vjetor⁸ të KPMD-së, deri në fund të vitit 2021, pra për një periudhë 6-7 mujore që nga koha kur Komisioni ka punuar efektivisht, **ka vepruar për 167 ank-esa**, 77 prej të cilave janë të trashëguara nga përbërja e mëparshme e atij organi, i cili nuk funksiononte më. Komisioni **ka marrë 90 parashtresa të reja** që kur është formuar, duke treguar se besimi në këtë organ është në rritje, dhe deri në fund të marsit të vitit 2022 ka hapur edhe disa raste në bazë të gojëdhënave, me ç'rast duhet të theksohen rastet që lidhen me lëvizjen fetare Lev Tahor dhe me diskriminimin e një vajze me nevoja të veçanta arsimore nga një shkollë në Gostivar, i cili përfundoi në mars me mendimin e Komisionit se është bërë diskriminim dhe me rekomandime se si të eliminohet ai. Në gjysmën e parë të muajit prill, SH.F. "Bashkimi" nga Gostivari me prova me shkrim e ka njoftuar Komisionin se diskriminimi është eliminuar dhe se janë pranuar dhe zbatuar rekomandimet e KPMD-së.

Sa i përket parashtresave, ato vijnë më shumë nga meshkujt sesa nga femrat, kryesisht janë nga Shkupi, kurse baza më e zakonshme është "statusi personal" (kualifikim kur nuk mund të përcaktohet se mbi çfarë baze është parashtresa - v.j.) dhe "statusi shoqëror". Deri në fund të vitit 2021, Komisioni ka konstatuar diskriminim në 40 raste, ndërsa në 39 është konstatuar se nuk ka bazë për diskriminim. Për 10 parashtresa Komisioni ka nxjerrë konkluzion për mosveprim, mosfillim apo ndërprerje të procedurës, ndërsa 41 parashtresa janë refuzuar për shkak të konstatimit të moskompetencës, parregullsive, vjetërsimit dhe papranueshmërisë. Për 37 parashtresa procedura është në vazhdim dhe janë regjistruar si lëndë të hapura" [fq. 22 e Raportit Vjetor](#)).

NUMRI I PARASHTRESAVE RRITET EDHE NË VITIN 2022

Puna e suksesshme e Komisionit gjatë shtatë-tetë muajve të vitit të kaluar, për aq sa anëtarët e tij realisht kishin sado pak kushte pune, është e njohur qartë nga publiku. Këtë e tregojnë edhe numrat, sepse vetëm deri në fund të marsit ose për tremujorin e parë të vitit 2022, Komisioni ka marrë **57 parashtresa të reja**, kurse gjithsej kanë punuar në 95 parashtresa. Vlen të theksohet se 3 procedura janë nisur me iniciativë të KPMD-së, që tregon se mekanizmi i ashtuquajtur "gojëdhënat", i cili është inkorporuar edhe si kompetencë ligjore e Komisionit, respektohet dhe funksionon⁹. Sipas strukturës së parashtresave, është rritur pak numri i personave juridikë si parashtresues, por është ende herët për të nxjerrë përfundime nëse kjo tregon një trend. **Por, është edhe më interesant fakti se pak më shumë se gjysma e parashtresave të pranura në këtë periudhë janë nga fusha e informimit publik, dhe kur të mbledhen edhe ato të vitit të kaluar, arrihet në përfundimin se diskriminimi përmes rrjeteve sociale dhe më rrallë përmes mediave digjitale apo atyre tradicionale është një realitet në vend.**

Në tremujorin e dytë, gjegjësisht deri në mbylljen e këtij raporti, janë pranuar më shumë se dhjetëra parashtresa. Komisioni, sipas të dhënave jozyrtare të marra nga vetë KPMD-ja, gjysmën e parë të vitit 2022 **pret ta kompletojë me gjithsej mbi 130 parashtresa**, ndërsa shifrat zyrtare përfundimtare do të publikohen në korrik, në raportin e dytë tremujor.

Përveç kësaj, në këto dy tremujorë të vitit, Komisioni ka punuar edhe në ekipimin shtesë të tij, si dhe në një sërë aktesh të brendshme për veprim, të cilat janë të rëndësishme për punën e KPMD-së, siç është akti për anonimizimin e të dhënave, akti që do të rregullonte punën e vullnetarëve etj. dhe, përveç kësaj, krijimi i një akti nënligjor që do ta rregullonte me saktësi procedurën për transferimin e barrës së provës tek diskriminuesi i potencuar.

KPMD-JA KA KËRKUAR BUXHET DERI NË 730 MIJË EURO, MIRËPO KA MARRË PAK SE 315 MIJË (ME REBALANCIN)

Megjithatë, sfidat me të cilat përballen ky organ mbeten, mbi të gjitha në aspektin organizativ dhe në zbatimin e vendimeve të tij. Deri në fund të vitit 2021 u plotësuan më pak se gjysma e vendeve të punës sipas sistematizimit të vetë Komisionit (29 vende pune dhe vetëm 10 nëpunës administrativë të marrë nga institucione të tjera), që punojnë në dy sektorë që mbulojnë katër departamente të sistematizuara, me buxhet të shtetit i cili është për gjysmë e më shumë më i ulët se nevojat e identifikuar nga vetë Komisioni. Tashmë në tremujorin e parë të vitit 2022 janë

8 KPMD - mars 2022 - Raporti Vjetor 2021 - (në dispozicion në <https://bit.ly/36l5onG>)

9 KPMD – Prill 2022 - Raporti tremujor (fq. 7) - (në dispozicion në <https://bit.ly/3lxJql7>)

plotësuar edhe dy vende pune me transferim të punonjësve, ndërsa pas konkursit të hapur për marrjen vullnetare nga administrata publike edhe dy të tjera dhe në tremujorin e dytë edhe dy vende të tjera, kështu që gjysmën e parë të vitit KPMD-ja e përmbyll me 16 nëpunës, gjë që do të ndihmojë dukshëm në efikasitetin e saj gjatë këtij viti. Në mars të vitit 2022, kryetarja e parë e Komisionit, **Vesna Bendevska** deklaroi se Ministria e Financave nuk ka shprehur interesim për kërkesën e Komisionit, as trupi punues në Kuvend, përgjegjës për financim dhe buxhet nuk ka treguar interesim, kështu që nga buxheti i kërkuar prej 730 mijë euro për një vit, është kopjuar buxheti i vitit 2021 prej 15,3 milionë denarë (më pak se 250 mijë euro) ose vetëm 120 mijë denarë më shumë se vitin e kaluar¹⁰.

Megjithatë, në intervistën¹¹ e realizuar në maj për qëllimet e këtij raporti, Bendevska konfirmon se raporti në mes të pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ ngadalë po ndryshon për të mirë, gjegjësisht se dalë ngadalë ka mirëkuptim për nevojat infrastrukturore, kadrovike dhe financiare të Komisionit për ta përmbyllur plotësisht rolin e saj. Kjo rezulton me dialog me Ministrinë e Financave gjatë përgatitjes së rebalancit të buxhetit të shtetit dhe me rritje të buxhetit të Komisionit për 4 milionë denarë të tjerë ose rreth 65 mijë euro me rebalancin e miratuar nga Qeveria në fund të majit, me të cilin KPMD-ja për vitin 2022 ka **buxhet total prej 315 mijë euro**.

Sigurisht, kjo është ende larg nevojave, por Komisioni shprehet i kënaqur që ishte i vetmi nga katër institucionet e pavarura në vend, që në kushtet e shkurtimeve të mëdha dhe deficitit, mori më shumë mjete me rebalancin.

Përveç kësaj, pushteti ekzekutiv ka treguar mirëkuptim edhe për nevojën për një numër më të madh të nëpunësve administrativë (gjë që vërtetohet edhe nga raporti tremujor), por mirëkuptim më i madh është shprehur edhe nga Kuvendi, pasi kësaj radhe kanë marrë premtimin se do të thirren në Komisionin parlamentar për Financim dhe Buxhet gjatë miratimit të raportit vjetor për vitin 2021 dhe nevojat financiare të Komisionit për vitin 2022 dhe kjo ndodhi, megjithëse raporti i tyre ende nuk është shqyrtuar për shkak të ngecjes së punës së komisionit parlamentar me pika të tjera.

KPMD-ja ka ende probleme në funksionim, për sa i përket infrastrukturës dhe mirëmbajtjes së objekteve, e për të qenë një organ plotësisht funksional dhe i pavarur siç përcaktohet me ligj, KPMD-ja ka inicuar ndryshim në ligjin amë.

- Ne synojmë të iniciojmë ndryshime në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, në nenin 15, paragrafi 4, në mënyrë që të jemi plotësisht të pavarur, por kjo do të kërkojë edhe ndryshim të plotë të Ligjit për Ekzekutimin e Buxhetit. Në paragrafin 4 të Ligjit thuhet se pas përcaktimit të buxhetit vjetor nga Kuvendi, Komisioni në mënyrë të pavarur disponon me mjetet e pranura. Mirëpo, në praktikë nuk është kështu, sepse për punësimet e reja, p.sh., Komisioni fillimisht duhet të marrë leje nga Ministria e Financave, ashtu siç na duhet leje për çdo ridestnim të brendshëm të mjeteve të marra në bazë vjetore, gjë që tregon se, në fakt, pavarësia e komisionit nuk është e plotë, gjegjësisht ajo përsëri është e varur nga pushteti ekzekutiv - thotë Bendevska.

KPMD-JA KONSIDERON SE DUHET TË JETË NJË ORGAN KUNDËRVAJTËS

Komisioni ka edhe një nismë tjetër për ndryshimin e ligjit, për të cilin tashmë ka marrëveshje për formimin dhe anëtarësimin në një grup pune së bashku me organet e tjera të pushtetit ekzekutiv. Bëhet fjalë për ndryshimin e Ligjit për kundërvajtje dhe harmonizimin e atij ligji përmes ndryshimeve të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, me të cilin Komisioni në vend që autorizimit për të parashtruar kërkesë për kundërvajtje në njësitë kompetente për kundërvajtje në gjykatat themelore, do të mund të vet të shqiptojë urdhra kundërvajtës. Me fjalë të tjera, analizat e Komisionit treguan se ai duhet të të marrë edhe autorizim për të qenë edhe organ kundërvajtës dhe se në këtë mënyrë mbrojtja nga diskriminimi do të jetë më e shpejtë dhe më efektive.

¹⁰ "Win-win"/TV "Telma" - mars 2022 - Deklaratë e Vesna Bendevska - (në dispozicion në <https://www.youtube.com/watch?v=gS2R4po7bu0>)

¹¹ Dy biseda me Vesna Bendevsken në maj dhe qershor të vitit 2022

Duhet theksuar se edhe me zgjidhjen aktuale ligjore, Komisioni me mjaft shkathtësi e shfrytëzon mundësinë që me kërkesa të shumta drejtuar gjykatave themelore për procedura kundërvajtëse ndaj diskriminuesve, të cilët edhe pas konstatimit të diskriminimit të kryer nuk i kanë eliminuar shkaqet apo me shkathtësi, si miq të gjykatës i paraqesin edhe mendimet e tyre për rastet individuale. Komisioni po ashtu informon se kanë regjistruar diskriminim madje edhe në institucionet e pushtetit ekzekutiv dhe se punojnë në mënyrë aktive për ta eliminimin atë diskriminim.

Gjithashtu, anëtarët e Komisionit konsiderojnë se fakti që janë të vendosur në ish-ambientet e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, të cilat nuk ofrojnë qasje për personat me aftësi të kufizuara fizike, është një shqetësim, qoftë edhe vetëm për sa i përket mesazhit që ia dërgon publikut në lidhje me këta njerëz. Në Raportin Vjetor dërguar Kuvendit, KPMD-ja paraqet edhe rekomandime që i referohen ndryshimeve në ligj dhe zgjedhjes së anëtarit të mbetur të Komisionit, në mënyrë që ai të kompletohet me shtatë anëtarë.

AP – NUMRI I PARASHTRESAVE, PAS DISA VITESH RËNIE, ËSHTË NË RITJE TË LEHTË

Zyra e Avokatit të Popullit, një nga dy institucionet kryesore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, në fund të muajit mars i prezantoi të dhënat bazë për punën në Raportin Vjetor për vitin 2021.

Sipas informacioneve që i paraqiti Avokati i Popullit, në vitin 2021 janë pranuar/regjistruar 2.686 parashtresa, ndërsa nga viti paraprak janë bartur 389 parashtresa ose janë regjistruar gjithsej mbi 3.000 lëndë. Me këtë rast, më të shumtat kanë qenë në fushën e drejtësisë - 436 parashtresa ose mbi 16 për qind, pasuar nga parashtresat në fushën e të drejtave të fëmijëve - 254, në vendin e tretë kanë qenë parashtresat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve - 228, pastaj sa i përket të drejtave të punës - 218 parashtresa, në fushën e mbrojtjes sociale - 183 parashtresa, në fushën e punës së institucioneve ndëshkuese-korrektuese dhe edukative - 162 parashtresa, nga fusha e të drejtës së pronës - 150, nga fusha e urbanizmit dhe ndërtimtarisë - 136 parashtresa dhe parashtresat e tjera janë nga fusha të tjera¹².

Nga gjithsej 3.075 parashtresa, Zyra e Avokatit të Popullit ka vepruar në lidhje me 2.085 lëndë ose 67.80 për qind, dhe në 755 prej tyre është konstatuar shkelje e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe është intervenuar për eliminimin e këtyre shkeljeve. Me këtë rast, në 500 raste organet kompetente kanë vepruar, në bazë të intervenimit të Avokatit të Popullit, në 233 Avokati i Popullit është dashur të ndërhyjë në mënyra të tjera tek organet më të larta, ndërsa në 23 lëndë, në muajin prill ende pritej përgjigje nga institucioni apo organi kompetent.

Nga kjo shihet se efikasiteti i Zyrës së AP-së është pak mbi dy të tretat në raport me numrin total të rasteve që i punojnë, gjë që mund të varet edhe nga vendet e paplotësuara të punës sipas sistematizimit që e ka ky institucion.

¹² Avokati i Popullit - 29.3.2022 - Konferencë shtypi konferencën e Avokatit të Popullit të RMV-së - (në dispozicion në <https://bit.ly/3NuMgdp>)

100 VENDE TË PAPLOTËSUARA TE AP SIPAS SISTEMATIZIMIT

Me Rregulloren e fundit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin Profesional, Ekipi i Mekanizmit Parandalues Kombëtar, Njësitë e Posaçme dhe Zyrat e Avokatit të Popullit APR nr. 1695/3 të datës 1.7.2021, janë planifikuar 183 vende pune për kryerjen e detyrave të punës, prej të cilave, deri në dhjetor të vitit 2021, janë plotësuar 85 vende.

Në Raport, në seksionin e treguesve statistikorë, shihet gjithashtu se numri i parashtresave të pranuar, krahasuar me disa vite më parë, është në rënie, gjë që sipas ekspertëve që i konsultuam për këtë raport (ekspertë të të drejtave themelore), mund të tregojë për një tendencë se publiku nuk e percepton zyrën e AP-së apo vetë AP-në si një institucion që mund t'u ndihmojë ose të jetë efikas nëse ankohen.

PARAQITJA TABELORE ME NUMRIN E PARASHTRESAVE TË PRANUARA/REGJISTRUARA (BURIMI AP)

2016	2017	2018	2019	2020	2021
3775	3223	3458	3453	2448	2686

Avokati i Popullit, Naser Ziberi, i ftuar në televizionin "Telma" më 25.05.2021, theksoi se falë bashkëpunimit me mediat (veçanërisht me këtë televizion) me qëllim të rritjes së dukshmërisë së Zyrës së AP-së dhe njohjes së institucionit nga qytetarët si organ që është në mbrojtje të të drejtave të tyre themelore, numri i ankesave në pesëmujorin e parë të vitit 2022 është në rritje dhe është më i lartë krahasuar me pesëmujorin e parë të vitit 2021, megjithëse nuk specifikoi të dhëna numerike. Pjesa më e madhe e ankesave kishin të bënin me drejtësinë, në fushën e zbatimit dhe punën e përmbaruesve, kompetencat e policisë, sektorin e sigurisë, veçanërisht e potencoi Agjencinë e Sigurisë Kombëtare, situatën në burgje, situatën me të drejtat e fëmijëve, veçanërisht në aspekt të arsimit dhe për herë të parë edhe parashtresa nga fusha e të drejtave që lidhen me strehimin.

Sa i përket bashkëpunimit të institucioneve, Ziberi tha se ka ndryshime për sa i përket sjelljes së Qeverisë, por jo edhe në mënyrën se si ajo përfshihet. Ai theksoi se Qeveria tani e informon rregullisht AK-në nëse Zyra pranon ndonjë ankesë për mosbashkëpunim të ndonjë personi drejtues apo organi administrativ, por vetëm me një njoftim zyrtar se ata e kanë përcjellë ankesën tek institucioni i theksuar dhe se janë në pritje të përgjigjes. Më parë, në fillim të shkurtit të vitit 2022, Avokati i Popullit, Naser Ziberi, njoftoi opinionin se është bërë analiza e veprimeve ndaj vendimeve apo udhëzimeve të Zyrës së Avokatit të Popullit. Ata zbuluan se "rreth 30 për qind e autoriteteve veprojnë në kohën e duhur, 30 për qind i përgjigjen kërkesës së përsëritur dhe 30 për qind nuk përgjigjen fare". Ziberi më pas tha se më pak bashkëpunues janë gjyqësori dhe aparati i detyrimit në vend, i cili ndihet i fuqishëm dhe nuk dëshiron kontroll. Mospërgjigja në kërkesën e Avokatit të Popullit konsiderohet si pengesë e punës së Avokatit të Popullit", tha Ziberi gjatë një paraqitjeje në emisionin "Utrinski brifiing", në ueb-televizionin e gazetës "Slloboden pečat".

Për sa i përket pjesës së iniciativës së Zyrës së AP-së, drejtuesi i këtij institucioni, në paraqitjen e përmendur më 25.5.2022, në televizionin "Telma", deklaroi se kanë ngritur tre çështje që mund ta përmirësojnë shumë situatën me të drejtat e një grup i madh qytetarësh:

- Një iniciativë deri te Kuvendi për ndryshimin e Ligjit për Obligacionet, me të cilën do të kufizohet edhe kamata ndëshkuese që e paguajnë qytetarët kreditorë ndaj debitorëve, ashtu siç është vepruar edhe më parë me kamatën kontraktuale (ankesa në fushën e përmbartimit).

- Një iniciativë në bashkëpunim me Komisionin Rregullator të Energjisë për ndryshimin e akteve nënligjore me të cilat operatorët e shërbimeve që kanë të bëjnë me energjinë elektrike dhe furnizimin me ujë do të jenë të detyruar t'i lexojnë njehsorët e energjisë elektrike dhe pajisjet e tjera të paktën një herë në tre muaj, në vend të një herë në vit siç është tani (ankesa për shkak të llogarive paushalle).

- Ndryshimi i lokacionit të burgut për të mitur për femra nga hapësirat e ShNK "Idrizovë" (lokacion i papërshtatshëm për dënim dhe risocializim).

SHTETIT NUK SFORCOHET ME PARATË, POR BUXHETI I AK-SË ENDE RRITET NGADALË

Zyra e Avokatit të Popullit, si në raportin vjetor të punës, ashtu edhe përmes kreut të Zyrës, në muajt e kaluar deklaroi se kishte një reduktim jo të vogël të mjeteve që i siguron shteti për funksionimin e këtij institucioni. Sipas pohimit të Avokatit të Popullit, Naser Ziberi, në konferencën për shtyp me rastin e prezantimit të raportit, buxheti për vitin 2021 është reduktuar kumulativisht për 30 për qind krahasuar me vitin 2020.

“Unë dhe ministri i Financave jemi në konflikt të përhershëm për çështje elementare, nuk kemi mjete për të kryer aktivitete. Kjo është e palejueshme. Për vitin 2021 buxheti është ulur për 10 për qind në krahasim me vitin e kaluar. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me rebalancin e buxhetit në gusht, ndërsa buxheti për vitin 2022 është 10% e tij. Për një vit buxheti është zvoëgluar për 30 për qind. Këtë e shoh si tendencë për të ngulfatur institucionin”, tha Ziberi¹³.

JA ÇFARË THOTË ZYRA E AP-SË PËR BUXHETIN NË RAPORTIN VJETOR PËR VITIN 2021:

“Buxheti për Avokatin e Popullit për vitin 2021 ka kaluar një rebalancim dhe një Vendim për rishpërndarje të mjeteve në mes të shfrytëzuesve buxhetor të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, me të cilin buxheti është ulur nga 83.755.000 në 77.738.000 denarë, gjegjësisht për 6.017.000 denarë, që paraqet një reduktim prej 5.3% krahasuar me buxhetin e vitit 2020. Viti 2021 do të shënohet si viti i dytë që kaloi në hijen e pandemisë me virusit Kovid-19 dhe si i tillë e ngadalësoi ritmin e punës, e uli vëllimin e aktiviteteve promovuese dhe aktiviteteve të tjera dhe vendosi rrethana kufizuese për punë. Realizimi i buxhetit të reduktuar ishte në masën 95%. I shprehur në shifra, buxheti i Avokatit të Popullit pas rebalancit dhe dy rishpërndarjeve të kryera ishte 76.762.200,00 denarë, ndërsa nënprogrami MPK kishte në dispozicion 375.000,00 den. Për shkak të mosekipimit të mekanizmit të kontrollit qytetar me tre anëtarë të jashtëm dhe mos aktivizimit të tij në atë kuptim, mjetet që ishin ndarë për këtë nënprogram u ridestinuuan për nevojat tjera, duke mbetur vetëm 800,00 denarë. Mekanizmi për monitorimin e zbatimit të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara kishte 300.000,00 denarë, ndërsa Raportuesi Kombëtar për Trafikimin me Njerëz dhe Migrimin Ilegal kishte 300.000,00 denarë. ose gjithsej 77.738.000,00 denarë ishte buxheti i institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2021”.

¹³ Alsat TV/ueb - 30.9.2022 - Ziberi akuzon qeverinë se dëshiron ta ngulfasë... (në dispozicion në <https://alsat.mk/mk/ziberi-obvinuva-deka-vlasta-saka-da-ja-zadushi-institutsijata-pravobranitel/>)

Megjithatë, nga rishikimi në Buxhetin e vitit 2022¹⁴ dhe krahasimet për disa vitet e kaluara, nuk mund të fitohet kjo përshtypje. Përkatësisht, në ndarjen 31101 të buxhetit thuhej se për vitin 2021 shpenzimet e përgjithshme të institucionit APishin 81.755 milionë denarë (1,327 milionë euro), ndërsa për vitin 2022, 85.600 milionë denarë (1,390 milionë euro) ose rritje për rreth 63 mijë euro. Me rebalancin e majit të vitit 2022, kjo shumë pritet të rritet edhe më tej. Kjo nuk përjashton mundësinë që me rebalancin e vitit 2021, me të vërtetë janë reduktuar një pjesë e mjeteve në dispozicion të AP-së.

Konkluzioni i përgjithshëm do të ishte se shteti nuk sforcohet me para për mbrojtjen e të drejtave themelore kur bëhet fjalë për Zyrën e Avokatit të Popullit. Megjithatë, është fakt se buxheti është rritur pak nga pak vitet e fundit. Me rebalancin e buxhetit nga fundi i majit, Zyra e AP-së merr plus dy milionë denarë direkt nga buxheti i RMV-së dhe rreth 600 mijë denarë nga donacionet, kështu që buxheti i AP-së për vitin 2022 do të duhej të jetë 88,199 milionë denarë ose **rreth 1.432 milionë euro**, për dallim nga buxheti i përcaktuar në dhjetor të vitit 2021 për vitin 2022 **prej 1.327 milionë euro** (kursi është llogaritur sipas kursit mesatar të Bankës Popullore prej 61,6 denarë për një euro - v.j.).

KUSHTET E KËQIJA NË BURGJE MBETEN NJË PROBLEM I PAZGJIDHUR

Një nga problemet kryesore me realizimin e të drejtave themelore në RMV janë të drejtat e personave që qëndrojnë në institucionet ndëshkuese-korrektuese. Kjo situatë e keqe është vërejtur me vite si nga mediat ashtu edhe nga Zyra e Avokatit të Popullit (AP), nga organizatat joqeveritare që merren me këtë çështje, si p.sh. Komiteti i Helsinkit, por edhe në Raportin e KE-së për RMV-në për vitin 2021, në Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për respektimin e të drejtave të njeriut, në raportet e Këshillit të Evropës për Maqedoninë e Veriut dhe Komitetit të Këshillit të Evropës (KE) për parandalimin e torturës.

Sipas AP-së në Raportin për vitin 2021, numri i parashtresave për këtë çështje është brenda mesatares së vitit 2020, gjegjësisht kanë pranuar 161 parashtresa (170 për vitin 2020). Vlerësimi nga analiza e parashtresave, por edhe nga hulumtimi në terren i Zyrës së AP-së nga gushti i vitit 2021, është se problemet kryesore në institucionet ndëshkuese-korrektuese (INK) janë në dy drejtime: **a) mosdhënia e mbrojtjes bazë shëndetësore; b) infrastruktura e dobët dhe mbipopullimi në burgje.**

Informacionet që kanë marrë nga zyra e AP-së janë tronditëse. Përkatësisht, madje gjysma janë pa asnjë mbrojtje shëndetësore: **“Problemi me mbrojtjen shëndetësore të të dënuarve/paraburgosurve, assesit të zgjidhet as me reformën e re, sepse pothuajse gjysma e institucioneve ku janë të strehuar këta persona ende nuk kanë në dispozicion një mjek. Disa nga këto institucione për ta tejkaluar këtë problem vetë angazhojnë mjekë që të mos i lënë të dënuarit pa mbrojtje parësore shëndetësore.**

Përpos mjekut, gjysma e këtyre institucioneve nuk kanë as infermiere/teknik, ndërsa e keqe është gjendja edhe me ofrimin e mbrojtjes dentare dhe psikiatrike. Në shumicën e 11 INK-ve në RMV, gjendja e ambienteve të destinuara për mbrojtjen shëndetësore është gjithashtu e keqe, për sa i përket pajisjeve të vjetëruara: **“Ambulantat në institucione zakonisht përbëhen nga zyra e mjekut amë dhe një dhomë ekzaminimi, të cilat janë të pajisura me pajisjet bazë, një dollap adekuat për medikamente, një shtrat mjekësor, një matës të presionit të gjakut, një aparat**

për matjen e sheqerit, kurse vetëm disa institucione kanë aparate funksionale për EKG, defibrilatorë, bombola të oksigjenit dhe maska, etj., mirëpo, në shumicën e rasteve, pajisjet që i kanë ambulantat e burgjeve janë të vjetëruara ose jofunksionale”.

14 Kuvendi i RMV-së - dhjetor 2021 - Materialet e mbyllura / Propozim-buxheti për vitin 2022 - (në dispozicion në <https://www.sobranie.mk//materialdetails.nspx?materialId=60a3a254-9fc0-4ff1-b0b2-4c009a2073c6>)

Konstatimet e këtilla për kujdesin e dobët mjekësor ndaj të dënuarve dhe të paraburgosurve në vend prej vitesh janë bërë temë e raportimit të përgjithshëm apo të pjesshëm nga një pjesë e mediave. Por, situata shqetësuese për shkak të (mos)kujdesit mjekësor ndaj të burgosurve u theksua veçanërisht në një hulumtim gazetaresk të një emisioni të specializuar në një televizion kombëtar. Në burgun më të madh në Maqedoninë e Veriut, Idrizovë, për rreth 1.200 të burgosur kujdesen një personel mjekësor prej gjashtë vetash - një mjeke, dy infermiere, një laborant, një dentist dhe një infermiere stomatologjike. Ky ekip modest është shumë i vogël për të zgjidhur problemet, siç është problemi i numrit të madh të të varurve që janë terapi për rehabilitim, e problem akoma më i madh janë gjashtë rastet e dyshuara të të burgosurve me sëmundje malinje, që nuk e marrin kujdesin e nevojshëm mjekësor. Për njërin prej tyre, një shtetas i huaj i dënuar me 7 vite burg, i cili pasi u konstatua me melanom malinje, ndonëse në dhjetorin e kaluar kërkoi dhe mori lirim të përkohshëm nga burgu për mjekim, prokuroria kompetente apeloj kundër këtij vendimi, ndërsa Këshilli Penal i gjykatës, i cili nuk solli vendim urgjent për këtë ankesë, fajin ia hodhi Drejtorisë së INK Idrizovë, e cila sipas ligjit ka mundur të reagojë dhe ta lirojë të burgosurin. Epilogu është se i burgosuri ka vdekur më 18 dhjetor përderisa kjo çështje ligjore po vazhdonte nëpër institucione. Kjo është vetëm një pjesë e situatës në burgjet e Maqedonisë që u prezantua në televizionin “Telma” në kuadër të programit “Kod”¹⁵.

Problemi i dytë është mbipopullimi në burgje, shumica e të cilave janë në gjendje të keqe. Gjatë hulumtimit në terren të Avokatit të Popullit, kjo është konstatuar me shifra të sakta. Objektet aktuale të akomodimit janë për 1.947 persona të dënuar, kurse në momentin e vizitës janë gjetur 2.058 persona të burgosur. Me atë që, diku mbipopullimi është më i theksuar, e diku jo. Për shembull, burgu më i madh në vend, Idriziva, ka kapacitet për 900 të dënuar, ndërsa në gusht të vitit të kaluar aty ishin të vendosur 1.102 persona. Situata në burgun e Shtipit, ku ka kapacitet për 160 persona, është e njëjtë, në prag të alarmit, ku janë gjetur 227 persona.

Shqetësuese është edhe gjendja në edukative-përmirësuese, ku akomodohen persona të mitur, edhe atë nga dy aspekte. Në kuadër të INK Idrizovë ekziston shtëpia edukative-përmirësuese për femra të mitura, ku AP konstatoi se ato janë në kontakt të vazhdueshëm me të dënuarat madhore, gjë që, sipas AP-së, është e palejueshme. Ata në përgjithësi rekomandojnë se INK Idrizova nuk është vend i përshtatshëm për një institucion edukativo-përmirësues për të mitur. Aspekti i dytë shqetësues është procesi arsimor për të miturit në institucionet edukative-përmirësuese, i cili sipas AP-së nuk ekziston fare! “Një pjesë e institucioneve, nëpërmjet Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve, procesin edukativo-arsimor e sigurojnë në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe shkollat lokale, kurse një pjesë e institucioneve, organizojnë trajnime dhe kurse për mësimin e zanateve në profesione dhe fushave të ndryshme (p.sh. veprimtaria e përpunimit të drurit, saldatorë, kuzhinierë, bukëpjekës, kopshtarë, berberë etj.), për të cilat ndjekësit e trajnimeve marrin diploma përkatëse. Megjithatë, Avokati i Popullit konsideron se kjo mënyrë e sigurimit të arsimit për këta njerëz nuk është e mjaftueshme, sidomos për shkak se është e përkohshme dhe pa vazhdimësi, dhe për këtë arsye u rekomandon institucioneve kompetente për tejkalimin e situatës”.

Në maj të vitit 2022, në organizim të Universitetit “Shën Klimenti i Ohrit” në Manastir u mbajt Konferenca ndërkombëtare kushtuar risocializimit të personave të dënuar dhe fatit të tyre pas daljes nga institucionet ndëshkuese-korrektuese, me ç’rast edhe kreu i Drejtorisë për Zbatimin e Sanksioneve në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë deklaroi se risocializimi në vend është problem i madh, i ndërlikuar edhe më shumë nga fakti se personat e dënuar përballen me problemin për të gjetur punë pas vuajtjes së dënimit¹⁶.

15 TV “Telma”/”Kod” – 8.5.2022 – Burgje me shërbime të vogla mjekësore...- (në dispozicion në <https://www.youtube.com/watch?v=Z9HWDcxthkM&t=216s>)

16 TV “Sitel” - 11.5.2022 - Ekspertët paralajmërojnë - risocializimi i personave të dënuar nuk funksionon mirë - (në dispozicion në <https://sitel.com.mk/ekspertite-predupreduvaat-slabo-funcjonira-resocijalizacijata-na-osudenici>)

Lidhur me respektimin e të drejtave themelore të personave të burgosur dhe të dënuar, si dhe të personave të dërguar në institucionet edukative-përmirësuese, në raportin e rregullt vjetor për respektimin e të drejtave të njeriut për vitin 2021, të publikuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit,¹⁷ toni është i ngjashëm me tonin kritik të Raportit Vjetor të AP. Ky ton kritik është i ndryshëm nga raporti i SHBA-ve për vitin 2020, ku mbizotëronte një pasqyrë e përgjithshme më optimiste për këtë problem. Raporti i fundit amerikan i citon gjithashtu gjetjet e Komitetit të KE-së për Mbrojtjen nga Tortura, i cili në vitin 2021 në korrik e publikoi raportin nga vizita e jashtëzakonshme të realizuar disa muaj më parë. Me këtë rast, mund të gjenden citate se të burgosurit mbahen në një hapësirë shumë të vogël (për shembull, përmendet seksioni i hapur në INK Idrizovë, ku 91 të burgosur janë të vendosur nga 16 të burgosur në një dhomë prej 32 metrash katrorë) ose personat e dënuar me burg më të gjatë kalojnë 23 orë në qeli të këqija (të lagura dhe të pa ngrohura) dhe vetëm 35-40 minuta në ditë lejohen të ecin në oborret e burgut, gjegjësisht nuk kanë aktivitete të tjera.

Edhe në raportin amerikan theksohet se Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, e cila është përgjegjëse për burgjet, nuk ka mjete të mjaftueshme buxhetore, se ka dobësi në administratë etj. Por, shqetësuese është edhe shifra e pesë personave të vdekur nëpër burgje në vitin 2021 (edhe pse në vitin 2020 ka pasur tetë vdekje për shkaqe natyrore), me ç'rast vetëm një rast është vetëvrasje, ndërsa katër rastet e tjera janë si rezultat i gjendjes së keqe afatgjate shëndetësore pa kujdes adekuat shëndetësor për këta personat (shih raportin nga referenca 9).

DREJTORIA PËR SANKSIONE KA NJË BUXHET PREJ MBI 19,5 MILIONË EURO, POR EDHE AI NUK MJAFTON

Nisur nga kjo situatë, për qëllimet e këtij raporti, e kontrolloam buxhetin e Drejtorisë për Zbatimin e Sanksioneve, ku mund të konstatohet se nga viti në vit ai rritet ngadalë dhe pak nga pak, por rritet edhe numri i të punësuarve. Me rebalancin e buxhetit që është në Kuvend, buxheti i këtij organi është rritur për vetëm 6 milionë denarë, kështu që tani arrin në **1,046 miliardë denarë**, dhe gjithsej me të hyrat nga aktivitete vetëfinancuese dhe me kredi prej 116 milionë denarëve është **gjithsej 1,201 miliardë denarë** ose rreth **19,5 milionë euro**. Kjo është një ulje në krahasim me buxhetin e paraparë për vitin 2022 prej 1,327 miliardë euro ose për rreth 21,5 milionë euro, për shkak të zvogëlimit të shpenzimeve nga kredia për më shumë se 100 milionë denarë të destinuara pikërisht për ndërtimin dhe rikonstruktimin e INK-së. Në treguesit dalës jo vetëm që nuk ka punësime të reja, por vlerësohet se do të ketë 10 persona më pak se në vitin 2021 dhe numri i të burgosurve do të ishte rreth 100 më shumë, pra 2.650.

Krahasimi tregon se **në vitin 2018** me 771 punonjës, Drejtoria kishte një buxhet prej **rreth 733,8 milionë denarë**, në vitin **2019** me 974 punonjës kishin buxhet **prej rreth 752,3 milionë**, në **vitin 2020** me 1.010 punonjës **kanë pasur rreth 917,5 milionë denarë**, në **vitin 2021** me 1.039 punonjës **tashmë mbi 1 miliardë denarë** dhe me të njëjtin numër të të punësuarve për vitin 2022, buxheti me rebalancin është caktuar në 1,201 miliardë denarë (rreth 19,5 milionë euro), me ç'rast shpenzimet nga buxheti bazë janë paraparë mbi një miliard denarë, kurse 116 milionë denarë apo rreth 1.9 milionë euro janë kredi nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës. Kjo kredi, siç sqarohet në buxhetin themelor për vitin 2022, parashikon rikonstruksionin e INK-së përmes “një projekti për avancimin e procesit të ekzekutimit të sanksioneve nëpërmjet realizimit dhe avancimit të të drejtave të njeriut për sa i përket kushteve të akomodimit, higjienës, mbrojtjes shëndetësore dhe aktiviteteve të lira të personave të dënuar dhe të paraburgosur”.

17 2021 Country Reports on Human Rights Practices: North Macedonia – (gjendet në <https://www.state.gov/reports/2021-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia/>)

Një projekt i tillë duhet të vazhdojë edhe në vitin 2023 dhe 2024, për të cilin në buxhetin themelor dhe në rebalancin janë bërë projeksione për vitin 2023 dhe 2024 prej 369 denarë, gjegjësisht 430 milionë denarë, gjegjësisht rreth 6 dhe 7 milionë euro për dy vitet e ardhshme. Gjithashtu, për shtëpitë edukative-përmirësuese ku janë vendosur të miturit për këtë vit janë planifikuar 16 milionë denarë, ndërsa për vitin 2023 dhe 2024 nga mbi 66 milionë denarë, që paraqesin investime për shpenzime kapitale. **prej pak më pak se 3 milionë euro** për tre vite. Dallimi është se këto mjete dhe projeksioni zhvillimor i buxhetit për ShEP-të janë nga mjetet e veta.

Këta tregues bazë tregojnë se shteti, megjithatë, është i vetëdijshëm për problemet me të drejtat themelore të personave në qendrat e paraburgimit dhe burgjet në Maqedoninë e Veriut, që ishin rreth 2.500 persona në maj të vitit 2022, si dhe për kritikën e bëra në raportet vendase dhe ndërkombëtare. Por, kushtet kanë qenë të këqija për dekada, kështu që pa fonde edhe më të mëdha nga buxheti themelor vështirë korrigjohen dhe është e qartë se do të nevojitet edhe ndryshim ligjor, i cili do të mundësojë përfitime shumë më të mëdha si dhe punësimin e personelit të ri mjekësor në institucionet e këtyra. Por, jo vetëm për ta, por edhe për punonjësit e policisë së burgjeve, të cilët në qershor protestuan para INK Idrizovë me pretendimin se janë harruar nga shteti dhe se kjo mund të sjellë probleme të mëdha në të ardhmen. Problemi doli në pah pasi Ministria e Punëve të Brendshme kishte kryer kontroll në disa qeli në Idrizovë, ku ishin gjetur: drogë, celularë dhe thika, pas të cilit ishte djegur vetura e shefit të policisë së burgut, e parkuar në hapësirat e burgut.¹⁸ Kujdesi për punonjësit duhet të jetë shumë më i thellë, sepse vazhdimisht në raporte dhe shkrime të ndryshme mediatike ka edhe akuza për korrupsion për një pjesë të policisë së burgjeve, për çka situata në burgje sa vjen e ndërlikohet. Në fakt, ja se çka thuhet për këtë rast në reagimin e Komitetit të Helsinkit dhe Shoqatës së Juristëve të Rinj, që u publikua në fund të qershorit: “Si organizata që e monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtpërdrejtë gjendjen në objektet e burgjeve, dhe të nxitura nga aksioni i fundit i MPB-së në burgun e Idrizovës, theksojmë se ajo që u shfaq në media si konfiskim spektakolar i thikave, drogës dhe celularëve në burg, **në fakt, është një gjendje e zakonshme, që zgjat me dekada...** Presim që hetimi të jetë i plotë dhe gjithëpërfshirës **që më në fund dikush të mbajë përgjegjësi për të gjitha këto dështime në institucionet ndëshkuese-korrektuese**, për të cilën jemi dëshmitarë prej vitesh. Nëse edhe në këtë rast shmanget përgjegjësia e drejtpërdrejtë, vështirë se mund t'i presim ndryshimet e dëshiruara pozitive në të gjithë sistemin penitenciar... Situata në institucionet e mbyllura është gjithmonë një ilustrim i situatës më të gjerë sociale. Prandaj, shteti duhet të bëjë përpjekje dhe burime dhe të gjejë zgjidhje afatgjata për këto probleme sistimore. Veprimet e herëpashershme në burgje janë padyshim të nevojshme, por ato nuk do të sjellin asnjë përmirësim pa sanksionet përkatëse dhe pa masa konkrete në lidhje me kushtet materiale dhe stafin e nevojshëm profesional”¹⁹.

Gjatë ndryshimeve dhe kujdesit më të madh të shtetit, mbi të gjitha në aspektin financiar, sigurisht që do të duhen ndjekur [Strategjia kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar në Republikën e Maqedonisë së Veriut \(2021-2025\)](#), si dhe Strategjia për zhvillimin e shërbimit të provës në Republikën e Maqedonisë së Veriut me Plan veprimi (2021-2025), zbatimi i Ligji i Provës dhe rregullativa nënligjore dhe të gjitha dokumentet, dispozitat dhe akteve nënligjore. Edhe pse ligji i fundit është miratuar që në vitin 2015, ndërsa në Drejtori ka edhe një sektor të posaçëm për provën, rezultatet janë shumë të dobëta, gjegjësisht pothuajse nuk zbatohet, për çka arsyetimet janë politikisht të papranueshme për një pjesë të publikut profesionist²⁰.

18 TV “Alfa”/“Youtube” – 15.6.2022 – Protesta e policëve të burgjeve... (në dispozicion në <https://www.youtube.com/watch?v=KFobgRFPuVU>)

19 KHDNJ – 18.6.2022 – A do të mbajë dikush më në fund përgjegjësi....(në dispozicion në <https://mhc.org.mk/news/dali-konechno-nekoj-ke-snosi-odgovornost-za-propusti-vo-zatvorite/>)

20 Thjerra e gjelbër – 2020 – Analiza e shkallës së informimit për provën... (në dispozicion në <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/06/finalna-analiza-zelena-lupa.pdf>)

ZGJIDHJE E KEQE E PROBLEMIT TË PERSONAVE PA IDENTITET

Një nga problemet e veçanta të një grupi më të madh qytetarësh është çështja e marrjes së identitetit para organeve shtetërore, gjegjësisht regjistrimi në librat amë dhe marrja e dokumenteve bazë nga Ministria e Punëve të Brendshme, siç është letërnjoftimi dhe (ose) dokumentet e udhëtimit.

Zëvendësja e Avokatit të Popullit, Suzana Salii, në [një emision të TV “Telma”, më 9.3.2022](#), tha se Zyra ka shumë probleme, përkatësisht ankesa për punën e Drejtorisë për Udhëheqjen e Librave Amë (DULA). Ajo sqaroi se ankesat janë edhe për kërkesën dhe dorëzimin elektronik të dokumenteve dhe për dokumentet që kanë të bëjnë me personat e vdekur, por edhe me shtetësinë. Bëhet fjalë për qindra qytetarë, të cilët presin verifikim për marrjen e nënshtetësisë, si dhe për problemi me rreth 900 qytetarë që kanë dy numra amë. Por, Raporti Vjetor zbuloi edhe një të dhënë tjetër. Se rreth 400 fëmijë janë pa asnjë dokument.

“Pas hulumtimit të kryer në muajin prill, u konstatua se 60% e personave pa dokumente janë fëmijë të paregjistruar nën moshën 18 vjeç. Po ashtu, shqetësues është fakti se Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë nuk ka informacion për numrin e fëmijëve që kanë lindur pas përfundimit të thirrjes publike, dhe të cilët nuk i plotësojnë kushtet për regjistrim në Librin Amë të të Lindurve në përputhje me ligjin (duke pasur parasysh se edhe kjo kategori mbulohet nga Ligji për Personat e Paregjistruar në Librin Amë të të Lindurve). Sipas Avokatit të Popullit, ministritë e linjës së Drejtësisë dhe Punës dhe Politikës Sociale, në koordinim me Drejtorinë për Udhëheqjen e Librave Amë, duhet urgjentisht të gjejnë një zgjidhje të përhershme sistemator për këtë problem të përhershëm me fëmijët “ligjërisht të padukshëm”, duke qenë se Ligji për Fëmijët e Paregjistruar nuk u kanë mundur të gëzojnë të drejtat e tyre, gjë që bie ndesh me Konventën për të Drejtat e Fëmijës”, thuhet në Raport.

Sipas hulumtimit gazetaresk të “360 gradë” (shih referencën 6), nga mbi 723 persona pa identitet të evidentuar nga hartëzimi në terren para hyrjes në fuqi të Ligjit për Personat e Paregjistruar në Librin Amë të të Lindurve nga shkurti i vitit 2020 deri në fund të marsit të vitit 2022, tre muaj para skadimit të ligjit, në Librin e Posaçëm të të Lindurve janë regjistruar 318 persona, ndërsa me ligjin e vjetër janë regjistruar 94 persona.

KAPACITETI I ADMINISTRATËS - PENGESË PËR REALIZIMIN E NDIHMËS FINANCIARE

Një fushë tjetër ku numri i parashtresave drejtuar AP-së është rritur për rreth 30 për qind është realizimi i së drejtës për ndihmë minimale financiare nga shteti, ndihmë financiare për kujdesin ndaj një personi tjetër dhe ndihma e njehershme financiare.

Shumica e parashtresave i referohen të drejtave financiare nga mbrojtja sociale, përkatësisht e drejta për ndihmë minimale të garantuar (37), e drejta për kompensim për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër (35), e drejta për ndihmë të njehershme financiare (3), e drejta për kompensim për orar të shkurtuar të punës (2), e drejta për kompensim për shkak të aftësisë së kufizuar (3), kompensimi i përhershëm (3). Ndërsa disa nga parashtresat (16) i referohen të drejtës për sigurim social për të moshuarit (pensioni social), dhunës në familje (5), shërbimeve sociale (5), dhe në 23 raste qytetarët kanë kërkuar vetëm këshilla ligjore.

Sipas Zyrës së AP-së, kjo rritje, ndër të tjera, vjen edhe për faktin se Ligji i ri për Mbrojtjen Sociale i vitit 2019, në vend që ta thjeshtonte ushtrimin e këtyre të drejtave, i bëri ato më të komplikuar:

“Siç është theksuar edhe në raportin e mëparshëm vjetor, Ligji i ri për Mbrojtjen dhe Sigurinë Sociale i miratuar në vitin 2019, në vend që t’i lehtësojë procedurat për ushtrimin e të drejtës për kompensim të ndihmës dhe përkujdesje nga një person tjetër, përkundrazi, i ka komplikuar dhe i ka bërë këto procedura më të vështira. Zgjidhja e re ligjore, sipas së cilës kushdo, pa kufizim, mund të paraqesë një kërkesë, të kontribojë në rritjen e numrit të kërkesave të reja, së bashku me kërkesat për rinovimin e të drejtës së atyre që u është dhënë më parë kjo e drejtë, me një shqyrtim kontrollues edhe të atyre kërkesave nga periudha para aplikimit të ndryshimeve nga Ligji për Mbrojtjen Sociale dhe para formimit të komisioneve të reja. Kjo situatë ka kontribuar në zvogëlimin e mundësisë për gjetjen e një afati të përshtatshëm për shqyrtimin e secilës kërkesë të veçantë para komisioneve profesionale. Në kushte të tilla, komisionet nuk kanë mundur t’u përgjigjen në kohë dhe në mënyrë efektive kërkesave të qytetarëve. Sipas deklaratave të Ministrisë së Shëndetësisë, numri i kërkesave të parashtruara e ka tejkaluar kapacitetin e punës së komisioneve. Si pasojë e kësaj situatë, shumë qytetarë humbën pa të drejtë të drejtën e kompensimit për ndihmë dhe përkujdesje nga një person tjetër” (citim nga Raporti Vjetor për vitin 2021).

Ap-ja konkludoi gjithashtu se “një numri të madh të qytetarëve iu hoq e drejta për ndihmë minimale të garantuar në mënyrë të pajustificueshme, me arsyetimin se në mënyrë paarsyeshme kishin marrë mjete nga burime të tjera, si p.sh. lojërat e fatit, transferimi i shpejtë i parave, shpërblime si nxënës/student më i mirë i gjeneratës etj., të cilat ishin simbolike dhe nuk mund të ndikonin në përmirësimin e statusit të tyre social”.

“Më flagrant është rasti i një gjimnazisteje nga Shkupi, e para e gjeneratës (nxënësja më e mirë), familjes së së cilës i është hequr e drejta për ndihmë minimale të garantuar, për shkak të mjeteve si shpërblim për zgjedhjen si nxënësja më e mirë e gjeneratës”, u theksua në Raportin e AP-së për vitin 2021. Megjithatë, kjo histori përfundoi me sukses, pas disa ndërhyrjeve të AP-së.

Në raportin e AP-së për vitin 2021, përveç përshkrimit të gjerë të këtyre shkeljeve të të drejtave themelore, evidentohen edhe shumë fusha të tjera ku janë regjistruar parashtresa, e të cilat lidhen edhe me organet e hetuesisë, duke theksuar se Ministria e Punëve të Brendshme jo gjithmonë bashkëpunon me AP-në, sidomos jo Njësia e Kontrollit të Brendshëm për Zbatimin e Standardeve Profesionale. Një nga zëvendësit e AP-së, i ftuar në një debat televiziv, tha se është shumë interesante që kur AP-ja do të ngrejë kallëzim penal për sjellje joprofesionale të pjesëtarëve të MPB-së në Prokurorinë Publike, ai organ nuk reagon fare, ndërsa kur vetë MPB-ja bën kallëzim penal kundër pjesëtarit të saj, PP-ja e pranon menjëherë dhe vepron në lidhje me të²¹.

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE – MË SË SHUMTI VUAJNË FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Lidhur me realizimin e të drejtave themelore të fëmijëve në përputhje me dokumentet ligjore dhe juridike ndërkombëtare, si Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, mund të thuhet se problemi më i madh në RMV janë, në fakt, të drejtat e fëmijëve që kanë ndonjë formë të paaftësisë fizike ose intelektuale.

Edhe pse është bërë progres në atë drejtim në vitin 2021/2022, pasi që për herë të parë përmes Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale janë siguruar mjete financiare për 500 asistentë arsimorë dhe për një numër të caktuar asistentësh personalë, duket se nevojat janë shumë më të mëdha se ajo që e ofron shteti.

Gjegjësisht, sipas të dhënave të mbledhura nga Zyra e Avokatit të Popullit në tremujorin e fundit të vitit të kaluar, gjendja është si vijon:

21 “Win-win” - 14.4.2022 - Deklarata e Jovan Andonovski, zëvendës i AP-së - (në dispozicion në <https://www.youtube.com/watch?v=OB8oBPwMD-M&t=221s>)

Përmes ankesave të pranuara nga prindërit e fëmijëve, në lidhje me të drejtën e paplotësuar për asistent arsimor/personal, Avokati i Popullit e kuptoi se mungonin asistentët arsimorë dhe personalë për nxënësit me aftësi të kufizuara që mësojnë në shkollat fillore komunale. Rrjedhimisht, për të kuptuar situatën aktuale dhe sfidat në ushtrimin e kësaj të drejte, Avokati i Popullit i drejtoi një kërkesë për të dhëna të gjitha shkollave fillore shtetërore me qendër burimore, përmes të cilave caktohen asistentët arsimorë, si dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në lidhje me ofrimin e asistentëve personalë për të fituar numrin e asistentëve të kërkuar, kundrejt asistentëve të siguruar dhe të pasiguruar. **Konkluzioni që del nga përgjigjet e shkollave fillore me qendër burimore është se deri në tetor të vitit 2021 janë shpërndarë gjithsej 414 asistentë arsimor, ndërsa edhe për gjithsej 266 kërkesa nuk është dhënë përgjigje pozitive. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, numri i përgjithshëm i kërkesave të parashtruara për asistent personal është 26, prej të cilave janë ofruar gjithsej nëntë asistentë personal, pesë kërkesa janë refuzuar si të pabazuara, ndërsa për 12 kërkesa procedura nuk është përfunduar për shkak të mungesës së asistentëve personalë të certifikuar të lirë.**

Përkundrejt këtij numri, ta përsërisim, MPPS-ja e përsërit vazhdimisht numrin prej 500 asistentësh arsimorë, por edhe nëse është arritur ky numër, nevojat në terren janë shumë më të mëdha. Këtë e ka vërtetuar edhe përgjigja zyrtare që ka marrë [redaksia e "Portalb"-it në hulumtimin për këtë temë](#) e publikuar në qershor të këtij viti në projektet mediatike të Fondacionit "Metamorfozis":

"Ministria shton se Qeveria nga ky vit **siguroi mjete dhe angazhoi 500 asistentë në mësimdhënie, për të cilët janë siguruar 216 milionë denarë**, dhe të cilët i mbështesin mësuesit në punën me nxënësit me aftësi të kufizuara, ndërkohë që Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka bërë ndryshime ligjore që e ulin kufirin e moshës për shfrytëzimin e shërbimit të asistencës personale nga **18 vjet në 6 vjet**. Në këtë moment **janë të punësuar 150 asistentë personalë, të cilët ofrojnë mbështetje për 217 fëmijë/persona me aftësi të kufizuara. dhe 126 persona të angazhuar në kujdesin dhe shërbimin e kujdesit në shtëpi për gjithsej 301 persona**"²².

Vlen të theksohet se në rebalancin e buxhetit për vitin 2022 të dorëzuar në Kuvend në maj, në programin për mbrojtjen e fëmijëve ka rritje të buxhetit të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale - nga 157 në 183 milionë denarë, edhe atë më së shumti për ndërtimin e objekteve për mbrojtjen e fëmijëve (çerdhe), por rritje ka edhe në programin për deinstitutionalizimin dhe shërbimet sociale - nga 242 në 345 milionë denarë, të cilat më së shumti janë të destinuara për fëmijët në shtëpitë familjare me grupe të vogla, në vend të ish-qendrave të mëdha shtetërore për këtë qëllim.

PROBLEME TË TJERA TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Një nga problemet kryesore është se shteti nuk mund të udhëheqë një politikë afatgjatë nëse nuk i di saktësisht nevojat se ku duhet t'i ndajë fondet. Shteti ende nuk ka një regjistër të personave me aftësi të kufizuara, megjithëse tashmë është bërë një përparim me regjistrimin e popullsisë të vitit 2021.

Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi që më 3.12.2021, në Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, doli me katër rekomandime strukturore për pushtetin ekzekutiv dhe të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të këtyre personave. Një nga rekomandimet më të rëndësishme, përveç qasjes së barabartë në shërbimet shëndetësore dhe vaksinat në kohë pandemie, është që përfundimisht të zhvillohet një regjistër kombëtar për këta persona, në mënyrë që në të ardhmen të mund të miratohen politika më të suksesshme dhe të

²² "Portalb"/"Vërtetmatës" - 7.6.2022 - Reformat sociale nuk mjaftojnë për fëmijët dhe personat me nevoja të veçanta - (në dispozicion në <https://vistinomer.mk/socijalnite-reformi-nedovolni-za-decata-i-licata-so-posebni-potrebi/>)

zbatueshme si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të këtyre personave²³. Sipas vlerësimeve të ekspertëve që janë përfshirë në këtë çështje dhe të cilët janë konsultuar për këtë raport, në RMV janë mbi 200 mijë persona me ndonjë lloj aftësie të kufizuar dhe ky numër me familjarët e tyre është shumë më i madh, sepse ekspertët theksojnë se duhet të shihni numrin total të personave që përballen me problemin – personat me aftësi të kufizuara, por edhe familjet e tyre.

Ky problem ka mundësi të tejkalohet pjesërisht me zbatimin e Regjistrimit të Popullsisë dhe të Amvisërive Familjeve të vitit të kaluar, sepse është bërë një numërim, por ende pa filluar regjistrimi, nga Enti Shtetëror i Statistikave (ESHS) thanë ose mohuan se ajo ishte një bazë e caktuar e përgjithshme, e cila mund të shërbejë për hulumtime të mëtejshme të thelluara²⁴.

Më në fund, në fillim të qershorit të këtij viti, ESHS-ja doli me këtë grup të dhënash nga regjistrimi i popullsisë, ku rezultoi se regjistruarit kishin numëruar rreth 94 mijë persona me aftësi të kufizuara të ndryshme. Më shumë detaje rreth njohurive të marra nga regjistrimi i popullsisë mund të shihen në analizën e bërë nga “Vërtetmatësi” në qershor të këtij viti, ku theksohet roli i vetëqeverisjes lokale në eliminimin e diskriminimit me të cilin ballafaqohen këta persona.²⁵ “Tani, me publikimin e të dhënave të regjistrimit të popullsisë, dihet saktësisht se në cilën komunë të vendit sa persona me aftësi të kufizuara ka dhe në varësi të kësaj mund të bëhen plane për të ardhmen në lidhje me atë se a ka nevojë dhe ku ka nevojë për më shumë qendra dhe qasje më të madhe në shërbime për këtë kategori personash. Varet nga kryetarët e komunave se sa do t’i përdorin këto të dhëna për të përmirësuar shërbimet për personat me aftësi të kufizuara në komunat e tyre” – thuhet në analizën e “Vërtetmatës”-it.

Krijimi i një Regjistri për vitin 2022 u njoftua edhe nga ministrja e Punës dhe Politikës Sociale në një takim në prill të vitit 2022 me përfaqësues të Organizatave Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar, por përveç kësaj, ajo theksoi përgjithësisht se çfarë parashikojnë politikat e shtetit, gjegjësisht përmes MPPS-së, për këtë vit:

- Të drejtat dhe shërbimet e reja për vitin 2022, të cilat janë rënë dakord me ministritë dhe fondet e tjera, janë: përjashtimi nga pjesëmarrja për personat me aftësi të kufizuara mbi 26 vjeç në shumën totale prej **16.000.000 milionë denarësh**, rritja e shumës për të drejtën për **shtesë të posaçme prej 15%** për të tre kategoritë e përdoruesve, nënshkrimi i kontratës për personat që përdorin implantet kokleare për blerjen e procesorit të të folurit, ndryshimi i rregullores për përcaktimin e listës së riparimeve të mjeteve ndihmëse ortopedike për mbulimin e kostove për rregullim dhe riparim të procesorit të të folurit, zvogëlimi i kohës për dhënien e mjeteve ndihmëse ortopedike - këpucë nga 9 në 6 muaj, ndryshimi i kriterëve për përdorimin e asistencës personale, gjegjësisht plotësimi me paaftësi të kombinuar ku dominuese është paaftësia trupore, kontrollimi i përafrimit të masës së të drejtave me kostot e jetesës, ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit për çmimin e shërbimeve sociale për vitin 2022, ku parashihet çmimi për një orë individuale dhe çmimi i trajtimit ditor për një fëmijë/person me aftësi të kufizuara nga një punëtor profesionist në qendrat ditore të licencuara për fëmijët me paaftësi, gjegjësisht **858 denarë** për trajtim individual dhe **1.053 denarë** në ditë për përdorues, të paguara përmes Qendrave për Punë Sociale, **futja e Regjistrit për personat me aftësi të kufizuara**²⁶.

Regjistri është vërtet i nevojshëm, sepse ka një mospërputhje mes shifrës prej rreth 200 mijë personash që e përmendin disa nga ekspertët në fokus grup dhe të dhënave nga regjistrimi i popullsisë, nga të cilët rezultoi se janë rreth 94 mijë persona, duke vënë në dukje, edhe një herë, se vetë ESHS-ja u distancua, duke deklaruar se ato numra nuk mund ta zëvendësojnë regjistrin.

Megjithatë, ndryshimi më i madh në drejtim pozitiv do të ndodhë ndoshta pasi të hartohet Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila u njoftua në fund të qer-

23 “Civil Media” - 3.12.2021 - Deklaratë e Vesna Bendevskës - (në dispozicion në <https://www.youtube.com/watch?v=B80xeb-u-9c>)

24 ESHS/Regjistrimi i popullsisë 2021 – 8.27.2021 – Regjistrimi i popullsisë do të mundësojë....për personat me aftësi të kufizuar – (në dispozicion në <https://bit.ly/3OW1uZQ>)

25 “Vërtetmatës” – 8.6.2022 – Regjistrimi i popullsisë zbuloi ... (në dispozicion në <https://vistinomer.mk/pop-isot-otkri-kolku-lugje-so-poprechenost-zhiveat-vo-opshtinite-na-red-se-gradonachalnicite-da-im-obezbedat-uslovi/>)

26 MPPS – 4.22.2022 – Komunikatë e MPPS-së – (në dispozicion në <https://www.mtsp.gov.mk/pocetna-ns-article-trencevska-zaednicki-kreirame-i-implementirame-politiki-koi-kje-go-unapredat-kvalitetot-na-zivot-na-.nspix>)

shorit të këtij viti, në një punëtori të organizuar nga Qeveria e RMV-së dhe Shoqëria Gjermane. për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ. Në këtë manifestim, kryeministri Dimitar Kovačevski dhe ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Jovanka Trenčevska folën për të gjitha të arriturat në drejtim pozitiv që janë realizuar deri më tani, por edhe për “modernizimin e politikave që mundësojnë punësimin e personave me aftësi të kufizuara”.²⁷

QENDRAT PËR MBROJTJE SOCIALE NJË NGA PROBLEMET PËR TË DREJTAT SOCIALE

Problem në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen dhe Sigurimin Social, por dhe i të gjitha të drejtave të tjera ligjore që duhet të zbatohen përmes MPPS-ës, janë padyshim qendrat e mbrojtjes sociale, të cilat duhej të transformohen dhe të ndryshohen që nga koha kur Mila Carovska ishte ministre dhe kjo ishte përfshirë në ligjin bazë në vitin 2019.

Ky përfundim për procesin ende të papërfunduar reformues të vetë qendrave mund të konstatohet edhe nga Koalicioni “Margjinat”, i cili në shkurt të vitit 2022 e prezantoi raportin e monitorimit për periudhën 2019-2021 për mënyrën e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen Sociale në fushën e shërbimeve sociale.

Teksti, siç u tha në prezantim, e vlerëson funksionalitetin e shërbimeve ekzistuese të mbrojtjes sociale, duke iu referuar zbatimit të Ligjit ekzistues për Mbrojtje Sociale dhe funksionalitetit të qendrave për punë sociale dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve sociale. Teksti fokusohet në tre grupe të synuara- romët, gratë viktime të dhunës dhe personat me aftësi të kufizuara, të cilat për shkak të pozitës së tyre specifike në shoqëri, për çdo ditë përballen me diskriminim dhe pamundësi për t’u integruar në shoqëri dhe një pjesë e madhe janë të varur nga transferimet sociale. Janë evidentuar dobësitë e qendrave për mbrojtje sociale, duke filluar nga ato infrastrukturore e deri te personeli dhe janë dhënë një sërë rekomandimesh për përmirësimin e punës së tyre, duke përfshirë zhvendosjen territoriale të qendrave të caktuara ose përfshirjen, gjegjësisht zgjerimin e iniciativës private dhe qytetare për të ofruar disa lloje të shërbimeve sociale dhe përfshirje më të madhe të vetëqeverisjes lokale në ofrimin e shërbimeve përmes qendrave për mbrojtje sociale²⁸.

Në konkluzionet e këtij hulumtimi për periudhën 2019 - 2021 saktësohet si në vijim:

“Ligji për Mbrojtjen Sociale ka një gjerësi të mjaftueshme shërbimesh dhe ofron një bazë ligjore për vendosjen e llojeve të ndryshme të shërbimeve, por nga përgjigjet e marra nga të anketuarit që i kanë shfrytëzuar ose kanë nevojë të përdorin ndonjë nga shërbimet, rezulton se nuk ka informim të mjaftueshëm në lidhje me llojet e shërbimeve të disponueshme. Qendrat për punë sociale, si institucione publike për mbrojtje sociale me kompetenca publike për kryerjen e punëve të mbrojtjes sociale, veprojnë në pajtim me ligjin dhe kompetencat e tyre. Ato zakonisht shërbejnë më shumë se dy komuna dhe zakonisht ndodhen në komunat më të mëdha. Në komunat më të vogla dhe ato rurale nuk ka njësi të qendrave për punë sociale. Për shkak të kësaj, qytetarët nga zonat rurale detyrohen të udhëtojnë në qendrën më të afërt të punës sociale, e cila paraqet një pengesë financiare dhe gjeografike për qasje në të drejtat dhe shërbimet e mbrojtjes sociale. Qendrat për punë sociale nuk kanë numër të mjaftueshëm të personelit profesional dhe teknik, si dhe pajisje adekuate teknike, zyra, automjete për në terren, pajisje kompjuterike, të cilat do të mundësonin kushte adekuate për punë me të gjitha kategoritë e qytetarëve. Qendrat nuk kanë ofruar hapësirë adekuate për pritje. Shpesh, në të njëjtën dhomë priten dhe punohet edhe me dy përdorues, gjë që nuk siguron privatësi të klientëve.”²⁹

Ky përfundim konfirmohet pjesërisht edhe gjatë hulumtimit tonë mbi respektimin e të drejtave që rrjedhin nga politikat e përfaqësimit gjinor dhe detyrimet e mbrojtjes që rrjedhin nga Konventa e Stambollit.

27 META.mk – Trenčevska: Përfshirja dhe respekti...(në dispozicion në <https://meta.mk/trenchevska-inkluzija-ta-i-pochituvanjeta-na-pravata-na-licata-so-poprechenost-e-edem-od-nashite-kluchni-prioriteti/>)

28 Rrjeti i Mbrojtjes nga Diskriminimi - Raporti i monitorimit (në dispozicion në http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2022/02/ZSZ_GolemDokument_WEB_v002.pdf)

29 Njësoj - fq. 79

PËRFAQËSIMI GJINOR, DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË FAMILJE JANË ENDE SFIDË!

Edhe pse RMV-ja e ka nënshkruar shumë kohë më parë dhe e zbaton në praktikë që nga viti 2018, të ashtuquajturën Konventë e Stambollit të Këshillit të Evropës, dhe para kësaj ka edhe strategji dhe ligje për eliminimin e pabarazisë gjinore, diskriminimit për shkak të përkatësisë gjinore, për shkak të seksit, problemet me dhunën ndaj grave, si dhe dhunën në familje, ende shihen në praktikën e përditshme. Për shembull, megjithëse gratë kanë arsim të njëjtë ose më të lartë se burrat, pjesëmarrja e grave në pozita udhëheqëse, si në biznes ashtu edhe në sektorin publik është shumë më e ulët, ashtu siç është dukshëm më i vogël edhe përfaqësimi i grave në politikë. Zgjedhjet e fundit lokale të mbajtura në vitin 2021 treguan se vetëm katër gra kandiduan për 81 mandate për kryetar komune, gjë që tregon se gratë e kanë të vështirë për të depërtuar edhe në veprimin politik të partive, dhe kjo shihet në përbërjen aktuale të Qeverisë së RMV-së, ku pjesëmarrja e grave është vetëm 20 për qind. Edhe kjo përqindje është vetëm për shkak të kuotave të detyrueshme gjatë kandidimit të deputetëve, përndryshe do të ishte minimale, ashtu siç është në vetëqeverisjen lokale. Kjo diferencë është reflektuar edhe në arsimin e lartë, ku nuk ka rektore femër, e po ashtu edhe numri i dekanëve është i vogël. Këto dhe shumë të dhëna të tjera u publikuan nga “Portalb”-i, “Vërtetmatës”-i dhe “Meta” në një hulumtim që e konfirmon hendekun e madh gjinor dhe i justifikon kritikën për këtë çështje që gjenden në raportet e fundit të KE-së.³⁰

Për të zbatuar Konventën e Stambollit, RMV-ja ka strategji për barazinë gjinore që nga viti 2013, kurse Strategjia e fundit 2021-2026 është në Kuvend që nga gushti i vitit 2021, për një kohë të gjatë është në fazën e leximit të dytë, megjithëse Ministria e Punës dhe Politika Sociale që në dhjetor të vitit 2021 e prezantoi para komisionit amë në Parlament³¹. Ekziston edhe një Plan Veprimi 2018-2023, kurse një përparim në drejtim pozitiv është bërë vitin e kaluar, kur për herë të parë u miratua Ligji për parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje, pas të cilit u miratuan edhe disa akte nënligjore nga MPPS-ja, por edhe nga ministri të tjera të ngarkuara me zbatimin, si MPB-ja dhe Ministria e Mbrojtjes.

Në raportin e përmendur tashmë të MPPS-së për grupin e ekspertëve të Këshillit të Evropës GREVIO, dërguar në prill (shih referencën 7), janë përmendur edhe të gjitha aktivitetet e realizuara në zbatimin e këtij dhe ligjeve të tjera, bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe të ngjashme. Për shembull, përmendet ligji, harmonizimi i ligjeve të tjera, rregulloret, numri i trajnimeve që i kanë realizuar për punonjësit e tyre për eliminimin dhe trajtimin e dhunës ndaj grave, politikën e ndërmarra në institucionet e tjera të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, dhuna me bazë gjinore (DHBGJ), dhuna në familje etj.

Padyshim, sipas mendimit të ekspertëve të fokus grupit, është bërë një përparim në aspektin e dokumenteve strategjike dhe ligjore, por si zakonisht, problem është zbatimi. E një nga problemet më të mëdha në zbatim janë financat, konsiderojnë ekspertët, duke thënë, për shembull, se Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje dhe ligje të tjera të ngjashme janë “ligje të shtrenjta”, gjegjësisht nevojitet edhe mbështetje më serioze financiare për zbatimin e tyre. Një nga problemet është zbatimi i detyrimeve ligjore për trajtimin e viktimave të tilla, nëpërmjet rrjetit të qendrave ekzistuese të mbrojtjes sociale, qendrave të strehimit, si dhe asistencës psikologjike për viktimat dhe trajtimi psiko-social i autorëve, për të mos u parë si të kthyer.

Problemi buron nga reforma ende jo e plotë e qendrave të punës sociale që ishte paraparë me Ligjin për Mbrojtje Sociale nga viti 2019 (të njëjtin problem e përmend edhe Avokati i Popullit në raportin e tij vjetor, duke folur për ushtrimin e së drejtës për ndihmë financiare, por edhe nga analiza e përgatitur për nevojat e Koalicionit “Margjinat” - shih referencat 27 dhe 28), trajnimi apo mungesa e personelit, me një fjalë, kapacitetet e sistemit për ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes sociale. Fokus grupi, si shembull theksoi se nuk janë përmbushur standardet sipas Këshillit të Evropës për trajtimin e viktimave dhe autorëve të dhunës (në të njëjtën dhomë nga të njëjtët

30 Portalb/Vërtetmatës - mars 2022 - Hendeku gjinor në RMV: burrat dominojnë tregun e punës ...- (në dispozicion në <https://vistinomer.mk/rodoviot-jaz-vo-rsm-mazhite-dominiraat-na-pazarot-na-trudot-i-so-povisoki-plati-bris-el-ostanuva-kritichen/>)

31 MPPS – 2021-12-24 – Komunikatë e MPPS-së – (në dispozicion në https://mtsp.gov.mk/pocetna-ns_arti-cle-shahpaska-so-strategijata-za-rodova-ednakvost-2021-2026-kje-ovozmozime-ednakva-vidlivost-na-zenite-i-nspix)

nëpunës - v.j.) se mungojnë qendrat e këshillimit, sepse në të gjithë territorin funksionojnë dhjetë qendra këshillimi për gratë viktime të dhunës në familje dhe 8 për trajtimin psiko-social të dhunuesve.

Shteti deklaron se MPPS-ja ka edhe “13 qendra për gratë viktime (dhe fëmijët e tyre) të dhunës në familje, nga të cilat tetë (8) janë njësi organizative të qendrës lokale për punë sociale, dy (2) financohen nga Ministria kurse menaxhohen nga shoqatat, dhe një (1) financohet nga vetëqeverisja lokale, kurse menaxhohet nga një shoqatë”³². Por, problemi i kësaj deklarate në raportin drejtuar grupit të ekspertëve të Këshillit të Evropës, sipas mendimit të ekspertëve që e kemi përdorur, është se, sipas ligjit, shteti duhet të ketë qendra të mjaftueshme për dhunën në familje, kurse të tilla janë tri nga qendrat e deklaruara, nuk ka asnjë qendër për dhunë seksuale dhe qendra strehimore për të cilat nuk dihet se sa janë. Ajo që dihet, për shembull, është se në rajonin e Pollogut, siç u theksua në një tribunë të organizuar së fundmi për këtë problem, nuk ekziston asnjë nga këto forma qendrash. Nuk ka asnjë linjë SOS që do të mund të funksionojë 24 orë në ditë. Ekziston vetëm një qendër për referimin e viktimave të dhunës seksuale, e cila është pjesë e Spitalit të Përgjithshëm në Tetovë, dhe për momentin numrat janë minimale për sa i përket asaj se sa gra dhe vajza janë viktime³³. Për më tepër, në të njëjtën ngjarje, [Ministria kompetente tha se problem është edhe monitorimi sistematik](#) (që është detyrim në bazë të ligjit): “Ajo që nuk ekziston në vend, por është e nevojshme, është një sistem të dhënash dhe monitorimi i çdo rasti nga denoncimi deri në përfundimin e tij, në mënyrë që të shohim se ku dështon sistemi dhe të jemi në gjendje të reagojmë, por edhe të kemi të dhëna që më tej do të shërbejnë për krijimin e masave dhe politikave të reja që synojnë përballjen me sukses ndaj dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë edhe dhunën në familje, theksoi Ministria e Punës dhe Politikës Sociale”. Kurse sistemi, sipas mendimit të ekspertëve në fokus grup, pikërisht në përputhje me atë që e thotë ministria, nuk i vlerëson trajnimet që i realizon për të parë nëse ka rezultat, gjegjësisht përmirësim në trajtimin e viktimave.

“Unë besoj në shifrat e qeverisë se qindra e qindra nëpunës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shembull, kanë pasur trajnime se si të sillen me persona të tillë dhe t’i ndjekin protokollet, por praktika na tregon se ka shembuj të mirë dhe të këqij, varësisht nga nëpunësi konkret policor”, thotë eksperti i konsultuar për këtë raport.

Meqenëse edhe organizatat joqeveritare janë të përfshira në luftën për parandalimin, pengimin dhe trajtimin e dhunës ndaj grave, dhunës me bazë gjinore, fëmijëve viktime të dhunës etj., si dhe kanë të drejtë ligjore të jenë ofrues të shërbimeve të specializuara, shteti ndan çdo vit rreth 65 mijë euro, të cilat mund të vlerësohen se janë pak.

Paratë, dhe jo vetëm paratë, janë problem edhe për kompensimin e fëmijës viktime të dhunës, sipas Ligjit për të Drejtat e Fëmijëve. Sipas raportit tashmë të përmendur të MPPS-së për Këshillin e Evropës, Ministria e Drejtësisë ndan një buxhet për këtë qëllim, dhe për vitin 2020 dhe 2021 ai arriti në pak më shumë se 16 mijë euro. Problem, siç theksohet nga fokus grupi, nuk është vetëm shuma e vogël e parave, por edhe procedura e ndërlikuar sipas ligjit që një fëmijë të marrë paratë e dëmshpërblimit. Është përmendur një rast kur procedura për marrjen e dëmshpërblimit prej 400 mijë denarëve ka filluar në vitin 2014 dhe ka përfunduar vitin e kaluar, gjegjësisht në vitin 2021. Nga fondi i MD-së, që nga krijimi i tij janë dëmshpërblyer edhe shtatë fëmijë të tjerë.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje, viktimat kanë të drejtë në dëmshpërblim, kurse procedura për ushtrimin e kësaj të drejte është e rregulluar në Ligjin për Procedurë Penale dhe në Ligjin për Drejtësi për Fëmijët vetëm për kompensimin e dëmit të fëmijëve viktime të një veprë penale me elementë dhune. Në procedurë parlamentare është Propozim-ligji për pagesën e dëmshpërblimit monetar për viktimat e veprave penale të dhunshme, i cili parashikon pjesërisht dëmshpërblim për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Procedura ekzistuese për kompensimin e dëmit është e gjatë dhe e ndërlikuar dhe fillimisht zhvillohet në procedurë penale, e nëse nuk shqiptohet në procedurë penale, viktimat duhet të zhvillojë procedurë civile për të përcaktuar llojin dhe lartësinë e dëmit. Gjithashtu, procedura për ekzekutimin e dëmshpërblimit të dhënë bëhet edhe më e vështirë, veçanërisht kur ai nuk mund të arkëtohet nga autori i veprës penale.

32 MPPS – 5.4.2022 – Raporti i Maqedonisë së Veriut për GREVIO të KE – fq.11-(gjendet në <https://bit.ly/3McA9kl>)

33 SDK.mk – 24.5.2022 – Dhuna në familje në rritje... (Në dispozicion në <https://bit.ly/3NqKSZ8>)

Një përparim i vërtetë në këtë drejtim pritet me ligjin për pagesën e dëmshpërblimit monetar për viktimat e veprave penale të dhunshme, i cili ka ngecur në Kuvend, megjithëse u dorëzua në gusht të vitit të kaluar. Me këtë propozim-ligj, nëse miratohet, thjeshtësohen procedurat për pagesën e dëmshpërblimit, kështu që pritet vetëm një rritje e fondit për këtë qëllim, nëse autori nuk do të mund të paguajë dëmshpërblim, që zakonisht edhe ndodh.

Si të ngecura në Kuvend mund të veçohen edhe ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Penal, me të cilat u futën vepra penale siç është “përndjekja”. Por, edhe pse këto ndryshime janë përgatitur dhe dorëzuar në gusht të vitit 2021, ato nuk janë miratuar, megjithëse formalisht askush nuk ka kundërshtime për to, por “janë viktimë e pazareve mes partive në komisionet në Kuvend” (interpretimi i ekspertit. -v.j.) dhe, me shumë gjasa, do ta pësojnë fatin e pritjes së Kodit të ri Penal, i cili është paralajmëruar nga Ministria e Drejtësisë për në dhjetor të vitit 2022.

KOMUNITETI LGBT ENDE PËRBALLET ME SHUMË SFIDA DHE KËRCËNIME

Homofobia dhe transfobia janë ende të pranishme në një shkallë të gjerë në RMV. Edhe pse disa gjëra në përgjithësi janë përmirësuar, për shembull, nuk ka më sulme grupe ndaj anëtarëve të komunitetit LGBT, as ndaj qendrave apo formave të tjera të mbrojtjes të ofruara nga sektori joqeveritar, siç ishte deri para disa vitesh, gjuha e urrejtjes, dhuna nga urrejtja dhe diskriminimi mbi disa baza vërehen mjaft shpesh. Ky është konkluzioni bazë i ekspertit për këto çështje, i cili ka ndihmuar në përpilimin e këtij raporti në kuadër të fokus grupit.

Gjuha e urrejtjes dhe fjalimet diskriminuese stigmatizuese lidhur me komunitetin LGBT janë më së shumti të regjistruara në rrjetet sociale, por edhe në media, kurse sektori joqeveritar konfirmon se është regjistruar edhe nga politikanë të zgjedhur apo të emëruar. E gjithë kjo, sipas ekspertit, mund të vërtetohet jo vetëm nga statistikat e mbajtura nga sektori joqeveritar, por edhe nga rastet tashmë të zgjidhura apo të dokumentuara të trajtuara nga Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Rasti i fundit i tillë i dhunës nga urrejtja, për të cilin eksperti konsideron se është nxitur nga gjuha e urrejtjes, madje edhe gjuha e papërshtatshme e politikanëve të partive politike apo deputetëve në Kuvend kur diskutuan për këtë çështje, është rrahja e një aktivisti LGBT, njëherit edhe kryetar i një organizate lokale LGBT nga Tetova, në maj të vitit 2022³⁴.

Përveç në rrjeteve sociale dhe mediat e përmendura, gjuha e urrejtjes apo gjuha shqetësuese që i diskriminon minoritetet seksuale dhe gjinore dhe grupet e cënueshme është regjistruar edhe në arsim, si në shkollat fillore ashtu edhe në ato të mesme, ku shembulli i fundit i konfirmuar është nga dhjetori i vitit 2022, kur me kërkesë të sektorit joqeveritar, KPMD-ja konstatoi vazhdimësi të diskriminimit në tekstin shkollor të sociologjisë³⁵. Përpjekja për të zgjidhur në mënyrë sistematike problemin në arsim, për të hequr këtë lloj gjuhe nga tekstet shkollore, dështoi pasi Ministria e Arsimit e tërhoqi ligjin përkatës për tekstet shkollore dhe mjetet ndihmëse didaktike, i cili edhe pse u fut në procedurë parlamentare, u kthye për rishikim. Tërheqja pasoi pas zhurmës së shkaktuar nga shoqatat joformale dhe formale të qytetarëve, të cilët kundërshtuan, në fakt, futjen e edukimit seksual joformal për fëmijët në klasën e 9-të, kështu që rishikimi i teksteve ekzistuese shkollore dështoi. Eksperti thotë se tani ky problem i është lënë raportimit individual të teksteve të tilla shkollore, nëse zbulohen, dhe disa raste të tilla tashmë janë realizuar. Por, kjo nuk është zgjidhje sistemore.

34 KHDNJ – 5.9.2022 – Të gjenden urgjentisht sulmuesit e Asanit... - (gjendet në <https://bit.ly/3tgrcPs>)

35 Koalicioni “Margjinat” - 28.12.2022 - Përmbajtje shqetësuese e gjetur në një tekst shkollor të sociologjisë për vitin e tretë - (në dispozicion në <http://coalition.org.mk/archives/12023>)

“LIGJI ËSHTË I MIRË - TRANSFOBINË E FUT NË SIRTAR”

Ky nëntitull është titulli i një komunikate për mediat e lëshuar në mars të këtij viti nga Koalicioni “Margjinat” në lidhje me fatin e ndryshimeve të propozuara në Ligjin për Evidencën Amë, i cili duhej ta zgjidhte në mënyrë sistematike problemin që e kanë personat transgjjinorë në lidhje me dokumentet zyrtare që duhet t’i marrin nga regjistrat e Drejtorisë për Udhëheqjen e Librave Amë.

Në fakt, propozimi për ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Evidencën Amë³⁶, i cili u dorëzua në Parlament në prill të vitit 2021, e tema kryesore e ndryshimeve të të cilit ishte e drejta për respektimin e përcaktimit të identitetit gjinor dhe seksual që u përkasin personave transgjjinorë, në mars të vitit 2022 u tërhoq nga procedura parlamentare kur, i shënuar me flamur evropian, doli në lexim të parë në komisionin amë.

Me ndryshimet dhe plotësimet duhej të bëhen ndryshime në mënyrë që edhe personat që nuk e kanë ndryshuar gjininë fizike, do të mund ta shprehin ndryshe gjininë e tyre, gjegjësisht si meshkuj, femra ose persona transgjjinorë. Propozimi për ndryshimin e këtij ligji ishte me kërkesë të disa organizatave joqeveritare që merren me mbrojtjen e të drejtave gjinore dhe themelore të njeriut. Vetë propozimi ishte i arsyetuar mirë nga propozuesi, me të gjitha arsyet pse kërkohet ndryshimi i këtij ligji, duke filluar nga konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga RMV-ja e deri te vendimet e Gjykatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, konkretisht edhe kundër RMV-së në vitin 2019.

Ligji, i cili prej disa ditësh ishte vënë në rendin e ditës së Komisionit për Legjislacion për lexim të parë, u tërhoq nga Qeveria e RMV-së dhe sipas deklaratave në dispozicion, duhej të përpunohet përsëri, të hapet një debat më i gjerë publik dhe më pas të kalojë në procedurë të rregullt parlamentare. Shkak për këtë është bërë kundërshtimi i fuqishëm i partive politike në Kuvend. Të gjitha partitë opozitare e kundërshtojnë miratimin e tij në këtë formë. Edhe pse mendohej se e kishte mbështetjen e LSDM-së në pushtet dhe të shumicës së partive më të vogla në koalicionin qeverisës, në fund doli se as në koalicionin në pushtet nuk kishte mbështetje (përjashtim është vetëm deputete), kurse partneri shqiptar në koalicion - BDI-ja, edhe pse heshti deri ditën e fundit, rezultoi se gjithashtu i kundërshton ndryshime e këtilla të ligjit. Arsyetimet janë llojllojshme. Partitë në pushtet këmbëngulin se ligji duhej të miratohet për shkak të shqetësimeve për buxhetin, i cili do të pësonte nga humbjet e gjyqimeve para Gjykatës së Strasburgut, dhe për shkak të zbatimit të këtyre aktgjyqimeve në legjislacionin e vendit, por se do të nevojitej procedurë e rregullt dhe debat më i gjerë. Pothuajse të gjitha partitë opozitare dolën me qëndrime konservatore, transfo-bike, në kuptimin se një ligj i tillë e cenon kuptimin tradicional të familjes dhe martesës, dhe se me ndryshimin e ligjit do t’i hapej rruga për ndryshimin e Ligjit për Familjen, ku martesë përkufizohet si bashkësi ligjore midis një burri dhe një gruaje, d.m.th. midis gjinive të ndryshme.

Organizatave joqeveritare shprehën dënimin e fortë për këtë tërheqje nga një proces për të cilin është punuar gjatë kohë dhe dënimin për sjelljen e të gjithëve, por edhe të deputetëve të grupit ndërpartiak që deklarativisht qëndronte pas kësaj ideje, ndërsa gjatë votimit, të gjithë deputetët u tërhoqën ose heshtën, me përjashtim të deputetes Maja Moraçanin, e cila qëndroi konsekuente. Më 21 prill [Qeverisë i është drejtuar edhe një letër nga deputetët e Parlamentit Evropian](#), të cilët apelojnë dhe kërkojnë nga Qeveria “të njihet njohja ligjore e gjinisë së personave trans dhe jobinarë në Ligjin për Evidencën Amë”. Nuk ka asnjë reagim në lidhje me këtë letër deri në përfundimin e këtij raporti, ndërsa njohuritë e fundit janë se Ministria e Drejtësisë ka një iniciativë për formimin e grupit punues për hartimin e një ligji krejtësisht të ri për evidencën amë, në kuadër të të cilit do të zgjidhej kjo çështje. Mirëpo, vetë fakti që Koalicioni “Margjinat” nuk është përfshirë në atë grup punues, lë dyshime tek eksperti i fokus grupit se problemi do të zgjidhet në nivel të kënaqshëm, e aq më pak – në kohën e duhur.

Përveç kësaj, personat transgjjinorë kanë edhe një sërë problemesh të tjera. Njerëzit që duan ta ndryshojnë gjininë e tyre, për shembull, nuk mund ta bëjnë këtë në RMV, sepse asnjë klinikë nuk e bën këtë. Por, edhe procedurat për ata që nuk duan ndryshim të plotë të gjinisë nuk përfshihen në sistemin shëndetësor publik dhe kryhen rast pas rasti, me njohje, miqësi apo intervenime. Për shembull, në paketën bazë të mbrojtjes shëndetësore nuk përfshihet as terapia hormonale

36 Kuvendi i RMV-së - Propozim për ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Evidencën Amë - mars 2022 - (në dispozicion në <https://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=09424067-36fb-4b7c-9853-d4c35ba5a28f>)

që duhet ta marrë një person në tranzicion, nëse në sistem nga mjeku amë deri te specialisti, megjithatë, merr një terapi të tillë. Në vitin 2019, në Ministrinë e Shëndetësisë u krijua një grup pune për zgjidhjen sistematike të këtij problemi, por për shkak të pandemisë së KOVID, grupi e ndërpreu punën pa rezultat. Pakënaqësia është e madhe, duke qenë se në Serbi, për shembull, e cila është shoqëri e ngjashme me Maqedoninë, ndryshimi i gjinisë bëhet në llogari të shtetit - 2/3 e shumës, kurse e gjithë procedura është e rregulluar rreptësisht me Ligjin për Mbrojtjen Shëndetësore nga mjeku amë deri në shkallën e fundit – klinika ku kryhen operacione të tilla. Një ekspert nga fokus grupi thekson se duke pasur parasysh faktin se shumë kirurgë nga RMV-ja janë të specializuar për këtë lloj procedure për shkak se kanë qenë në vizita studimore jashtë vendit, duhet vetëm pak vullnet i mirë nga qeveria, sepse ka njohuri profesionale, dhe me vetë faktin që numri i personave të tillë nuk është shumë i madh, të paktën jo publikisht, një ndryshim i tillë ligjor nuk do të ishte një barrë e veçantë për buxhetin e shëndetësisë.

PËRFSHIRJA E ROMËVE ËSHTË E INKORPORUAR NË MËNYRË SISTEMATORE, POR REZULTATET JANË TË PAMJAFTUESHME

Politika e shtetit në lidhje me përfshirjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi ndaj romëve, është në përputhje me politikën e përgjithshme të Bashkimit Evropian, që është potencuar në kuadër të procesit të Berlinit për vendet e Ballkanit Perëndimor, i cili në vitin 2019 rezultoi me Deklaratën e Poznanit³⁷.

Maqedonia e Veriut ka një dokument bazë që udhëzon përfshirjen e romëve në shoqëri - Strategjia për përfshirjen e romëve 2022-2030, e cila është miratuar në shkurt të këtij viti dhe që është pasuese e dy strategjive të mëparshme kombëtare për përfshirjen e romëve 2005-2015 dhe 2016-2020. Në mesin e ekspertëve ka dyshime nëse ky dokument strategjik është përgatitur mirë, por edhe nëse është bërë një analizë dhe vlerësim ekspert i strategjisë së mëparshme dhe i planeve të veprimit me të cilat është zbatuar për t'i konstatuar dobësitë e mundshme. Aq më tepër që strategjia u vendos në portalin kombëtar të dispozitave, ENER, në fund të dhjetorit të vitit 2021 dhe u miratua në shkurt të vitit 2022, megjithëse vetë Strategjia thotë se në pjesën e parë të vitit 2021 janë bërë përgatitjet e gjera konsultative, veçanërisht me organizatat joqeveritare që merren me pozitën e romëve në shoqëri.

Sipas Strategjisë, përfshirja do të koordinohet dhe zbatohet nga pika kombëtare e kontaktit për romët dhe koordinatori kombëtar për zbatimin e Strategjisë, gjegjësisht Këshilltari i Kryeministrit për përfshirjen e romëve, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Trupi Koordinues Kombëtar që përfshin ministri të ndryshme të linjës, Avokati i Popullit dhe Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, një grup parlamentar ndërpartiak i krijuar në fillim të vitit 2021 dhe të tjerë.

Vetë strategjia, në pjesën hyrëse, i konstaton parametrat bazë me të cilët vlerësohet përfshirja, me ç'rast vihet në dukje se janë konstatuar shifra më të këqija për sa i përket punësimit, gjegjësisht papunësisë së romëve për shkak të pandemisë së KOVID-it. Për sa i përket banimit (strehimit), thuhet se transferimet kapitale për këtë qëllim përmes Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve (MTL) kanë kontribuar në përmirësimin e situatës, por se komunat nuk kanë ndërmarrë asgjë, gjegjësisht se nuk i përdorin fondet e shtetit për urbanizimin e vendbanimeve romë. "Në fushën e shëndetësisë, gjendja e keqe socio-ekonomike e përkeqëson edhe më shumë situatën shëndetësore. Buxheti në Ministrinë e Shëndetësisë vazhdon të mbetet i pushfrytëzuar, ndërkohë që është ulur numri i ndërmjetësuesve shëndetësorë romë dhe ata nuk janë sistemuar në sistemin shëndetësor", thuhet në strategjinë e fundit.

Përparimi më i madh është bërë në aspekt të arsimit. Thuhet se është rritur mbulimi i fëmijëve në arsimin fillor dhe të mesëm, se 94 për qind e fëmijëve të regjistruar në arsimin fillor e përfundojnë arsimin e tyre, se janë dhënë rreth 850 bursa për fëmijë në arsimin e mesëm dhe rreth 100 bursa

37 Deklarata e partnerëve nga Ballkani Perëndimor për integrimin e romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së - 2019 - (në dispozicion në <https://www.rcc.int/romaintegration2020/files/admin/docs/866ab25893dd6d9271ebccbfd195349e.pdf>)

për arsimin e lartë etj. Shifrat e këtij viti, sipas konsultimeve që i kemi pasur për përgatitjen e këtij raporti, janë edhe më të larta. Për fëmijët në arsimin e mesëm për vitin 2021/2022, shteti ka ndarë 940 bursa në vlerë prej 2.200-2.800 denarë në varësi të kategorizimit dhe 140 bursa për studentë në vlerë prej 5.000 denarë për vitin akademik.

Por, me sa duket kjo nuk ka asnjë efekt në masat e punësimit për romët. Sipas të dhënave të paraqitura në Strategji, shihet se përqindja prej 5,9 për qind e romëve të papunë nga numri i përgjithshëm i të papunëve në vitin 2020 është rritur në 9,2 për qind ose në total mbi 14,4 mijë romë të papunë. E potencojmë arsimin dhe punësimin sepse sipas strukturës së romëve të papunë mbi 95 për qind janë pa arsim fillor ose me arsim fillor, 7,7 për qind me arsim të mesëm të pambaruar ose me arsim të mesëm dhe vetëm 0,3 për qind janë të papunë me arsim të lartë. Shpjegimi nga një ekspert i fokus grupit ishte se këto shifra të dobëta janë pjesërisht rezultat i diskriminimit në punësim, gjë që shpjegohet pak më poshtë në këtë raport.

Në lidhje me mbrojtjen shëndetësore, bashkëbiseduesit tanë theksuan se ka indikacione, por jo edhe dëshmi, përveç indikacioneve të organizatave joqeveritare, se romët gëzojnë një nivel më të ulët të cilësisë së mbrojtjes shëndetësore për disa arsye, ndër të cilat mund të veçohen ato popullata romë e paregjistruar pa dokumente personale, pa sigurim shëndetësor, sepse janë të papunë ose të punësuar joformalisht, por ka edhe indikacione për ndarje (segregim), për shkak të origjinës etnike, ngjyrës së lëkurës, ose kryesisht neglizhencës për shkak të origjinës sociale. Mirëpo, ka studime të organizatave ndërkombëtare, të cilat theksohen edhe në Strategji, se romët kanë një jetëgjatësi më të ulët për 10-20 vjet se të tjerët, se shkalla e vdekshmërisë tek të sapolindurit është 25 për qind më e lartë, e po ashtu dhe frekuenca e sëmundjeve kronike është më e lartë. Indikativ është edhe fakti se nga mbi 3 milionë denarë të parashikuara për mbrojtje shëndetësore në mbështetje të Strategjisë për gjithëpërfshirje, është shfrytëzuar vetëm gjysma, përkatësisht rreth 1,5 milionë denarë.

DISKRIMINIMI NDAJ ROMËVE ËSHTË NJË FAKT I KONFIRMUAR - SEGREGACION DHE RACIZËM

Sa i përket diskriminimit me të cilin përballen romët në Maqedoninë e Veriut, ai nuk është një fenomen i ri, ai është regjistruar edhe në periudhat e mëparshme (shih [Raport i vitit 2013 nga Instituti për të Drejtat e Njeriut](#)), e, për fat të keq, është regjistruar dhe konfirmuar si në vitin 2021 ashtu edhe në muajt e parë të vitit 2022, si nga sektori joqeveritar, ashtu edhe nga AP-ja dhe KPMD-ja. I referohet çështjeve nga infrastruktura dhe qasja në ujë, por edhe nga fusha e banimit, ku ka indikacione për ekzistimin e një diskriminimi të tillë, deri te diskriminimi i konstatuar në fushën e arsimit në nivelin e segregacionit. Bëhet fjalë për diskriminim indirekt të përcaktuar saktësisht, i cili çon në segregacion dhe ky rast është publikuar nga ana e KPMD-së.³⁸ Nëse e shikoni arsyetimin e Mendimit që Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi e konstatoi në shkurt të këtij viti, do të shihet se për rastin e parashtresës që iu ishte dorëzuar nuk ka faj shkolla fillore nga Shtipi, por se fajin kryesor që çon deri në themelimin e klasave etnikisht të pastra, Komisioni e sheh në Ligjin për Arsimin Fillor, në nenin 63, paragrafi 4, de facto, neni, i cili quhet Rajonizimi i shkollave dhe i cili u mundëson edhe prindërve dhe shkollës t'i regjistrojnë fëmijët e tyre ose të regjistrojnë fëmijë të tjerë jashtë zonës ku ndodhet shkolla³⁹. Komisioni miratoi gjithashtu një Rekomandim të Përgjithshëm në të cilin, ndër të tjera, i rekomandohet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të përcaktojë kriteret më të rrepta për ndryshimin e shkollave në një zonë tjetër jashtë zonës ku jetojnë fëmijët, gjë që do të ndihmonte në procesin e desegregimit të fëmijëve romë. Për këtë rast flet edhe Zyra e AP-së në Raportin Vjetor për vitin 2021, duke e theksuar si "tendencë për segregim të nxënësve për shkak të mosrespektimit të vendimit për rajonizim", e cila i ka dërguar Vërejtje edhe vetëqeverisjes lokale për shkeljet e bëra ([më shumë detaje në f.85 të Raportit Vjetor të AP-së për vitin 2021](#)).

Gjatë viteve 2021 dhe 2022, KPMD-ja ka konstatuar edhe disa raste të diskriminimit në bazë të nacionalitetit dhe racës, përkatësisht ngjyrës së lëkurës - dy raste të diskriminimit nga punonjësit e Ndërmarrjes së Transportit Publik Shkup, ku një rast është formë më e rëndë e diskriminimit

38 KPMD – 3.3.2022 – Mendim i KPMD-së – (në dispozicion në <https://kszd.mk/wp-content/uploads/2022/02/0801-306-od-08.10.2021-se-utvrduva-indirektna-diskriminacija.pdf>)

39 MASH - Ligji për Arsimin Fillor - fq. 26, neni 60 - (në dispozicion në <https://mon.gov.mk/stored/document/Zakon%20za%20osnovnoto%20obrazovanie%20-%20nov.pdf>)

ndërsektorial, raste të mohimit të së drejtës për mallra dhe shërbime për romët, siç është hyrja në dy kafe-bare, njëri në Berovë, tjetri në Prilep, etj. Në vitin 2022, KPMD-ja tashmë ka konstatuar diskriminim ndaj romëve në lidhje me të drejtën për furnizim me ujë të pastër në Kërçovë dhe Kavadar, e një rast i tillë ka ndodhur edhe në Strumicë.

- Diskriminimi që ka marrë formën e segregacionit ekziston edhe në fusha të tjera, siç është e drejta për lirinë e lëvizjes, kur kemi raste të regjistruara dhe të konfirmuara përmes një eksperimenti - testi, i kryer me transport të organizuar qëllimisht me autobus gjatë kalimit të kufirit shtetëror. Edhe ai test si dhe raportet e tjera që i kemi regjistruar treguan se ndodh që punonjësit e policisë t'i kontrollojnë hollësisht dhe t'i ndajnë romët nga autobusët, me arsyetimin se ka pasur keqpërdorim të marrëveshjes për udhëtim pa viza me vendet anëtare të BE-së. Por, shembujt janë nga kufiri maqedonas-serb, i cili mund të kalohet edhe me letërnjoftim - na tha një ekspert nga fokus grupi, i cili u konsultua për çështjet që kanë të bëjnë me romët.

Sipas të njëjtit ekspert, diskriminim ekziston edhe në punësim, edhe në sektorin publik dhe në administratën shtetërore, ndërsa arsyet janë të shumëanshme:

- Një nga arsyet është i ashtuquajti balancues, i cili rrallëherë tregon se në ndonjë institucion ka nevojë për punësimin e ndonjë romi/romëve. Problemi është tek metodologjia e përfaqësimit të drejtë (nënakti ligjor), e cila deri më tani ka nxjerrë të dhëna të gabuara nga regjistrimi i vitit 2002, dhe ne propozojmë që kjo të jetë nga numri i përgjithshëm i punonjësve, gjegjësisht të merren ato parametra, e jo numri i përgjithshëm i romëve. Por kemi edhe një rast, i regjistruar edhe nga Avokati i Popullit, i cili na tregoi se edhe kur "balancuesi" tregon se shtë i nevojshëm punësimi i një romi/romeje, punësohet një person tjetër punësohet – nga një komunitet tjetër – sipas përkatësisë partiake. Shembulli është nga Njësia rajonale e DAP në Prilep - thotë eksperti.

Arsyeja e dytë, sipas të njëjtit burim, është se bazat e të dhënave nuk janë të sakta, duke i përfshirë edhe rezultatet e regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2021.

- Regjistrimi i popullsisë nuk e pasqyron numrin real të të dhënave sepse, së pari, ka pasur një numër të madh të romëve të paregjistruar, dhe së dyti, ata që janë regjistruar janë manipuluar në dy mënyra - ndikimi i regjistruarëve, të cilët në disa zona as nuk kanë pyetur për përkatësinë etnike të të regjistruarëve dhe ndikimi i Turqisë dhe i komunitetit turk në RMV, qoftë përmes regjistruarëve, qoftë përmes organizatave për bashkëpunim dhe zhvillim, të cilat në mënyrë aktive lobuan dhe ushtronin ndikim në pjesë të komunitetit rom për t'u deklaruar si turq. Ndikime të tilla në komunitetin rom ka pasur edhe nga komuniteti lokal shqiptar ose nga anëtarët e partive politike të shqiptarëve në disa qytete të Maqedonisë Perëndimore, por në një shkallë më të vogël, për dallim nga problemet që i kemi regjistruar në një pjesë të Maqedonisë Qendrore dhe Lindore.

Ky gabim nuk mund të korrigojë as me krahasimin e kryqëzuar të të dhënave nga regjistrat dhe bazat e tjera të të dhënave të mbajtura nga institucionet tjera, siç është ajo e Agjencisë për Ndërmjetësim për Punësim – APRMV. Edhe atje ndodhin shumë "gabime" nga punonjësit e sporteleve, kështu që romët, punëkërkues aktiv apo pasivë, regjistrohen si të një etnie tjetër, në këtë rast si shqiptarë. Para do kohësh është bërë një kontrollim me testim, gjatë të cilit një mostër e përzgjedhur rastësisht prej 200 romësh në bazën e të dhënave të APRMV-së, rreth 30 për qind janë regjistruar si jo-romë - thotë eksperti i konsultuar për këtë raport.

Nga shembujt e përmendur më lart, mund të konstatohet se diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike dhe ngjyrës së lëkurës, d.m.th. diskriminimi ndaj romëve është ende një problem konstant në Maqedoninë e Veriut dhe gjatë vitit janë regjistruar disa raste në Komisionin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi dhe në Avokatin e Popullit, si dhe dhjetëra raste nga organizata joqeveritare që merren me mbrojtjen e të drejtave të romëve. Sipas gjendjes aktuale (raportet vjetore dhe statistikave), duket se KPMD-ja i shfrytëzon shumë më tepër instrumentet që i janë dhënë me Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, kështu që inicion edhe procedura kundërvajtëse me një formë më të rëndë kualifikuese si p.sh. diskriminimi ndërsektorial, ndërsa Avokati i Popullit kryen një rol më shumë; ndërmjetësues dhe vepron përmes vërjetjeve, urgjencave dhe rekomandimeve.

Strategjia përdor gjithashtu fjalorin e përdorur në Këshillin e Evropës dhe në KE, i cili është anti-ciganizmi, si një lloj forme komplekse e racizmit që regjistrohet nga jo-romët kundër romëve, për disa arsye. Një ndër synimet strategjike është reduktimi i anti-ciganizmit përmes një sërë masash dhe një ndër to është futja e anti-ciganizmit si vepër penale në Kodin Penal, për të cilin ka mendime kontradiktore mes bashkëbiseduesve tanë.

PËRFSHIRJA VUAN NGA MUNGESA E FINANCIMIT – SHUMË DËSHIRA, PAK PARA

Të gjitha paratë nga buxheti i caktuar për përfshirjen e romëve janë të përcaktuara sipas programeve dhe arrijnë në rreth një milion euro! Edhe pse këshilltari për përfshirjen e romëve në Kabinetin e kryeministrit, Dimitar Kovačevski, në një konferencë për media në muajin prill, deklaroi se Qeveria ka përcaktuar mjete shtesë për këtë vit, pra ato në total arrijnë në 73 milionë denarë, shqyrtimi ynë i rebalancit të buxhetit të dorëzuar në Parlament në fund të majit tregoi se mjetet totale për këtë qëllim (të listuara si Mbështetje për përfshirjen e romëve dhe zbatimin e Strategjisë së Përfshirjes 2022-2030), janë rreth **62,553 milionë denarë ose 1,1 milionë e 15 mijë euro** sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore.

Këto mjete janë të dedikuara për nënprograme që i zbatojnë kryesisht Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministria e Arsimit. Ato vërtet janë më të mëdha në krahasim me disa vite më parë, sepse atëherë ishin rreth 35 milionë denarë ose gjysma e asaj që është ndarë sot, por përshtypja e ekspertëve është se janë të pamjaftueshme.

- Në vendin tonë përfshirja e romëve nuk kuptohet si çështje politike, por si çështje sociale dhe kjo është dobësia kryesore, prandaj edhe përfshirja është relativisht e ngadaltë. Prandaj, edhe pse themi se ka vullnet politik dhe hapje për t'i zgjidhur të gjitha problemet me të cilat ballafaqohen romët në RMV, gjërat po shkojnë ngadalë. Sigurisht që financimi i masave që dalin nga Strategjia për arritjen e gjithëpërfshirjes janë gjithashtu vendimtare dhe se rreth një milion euro të ndara për këtë vit janë të pamjaftueshme, pra pak. Por, nga ana tjetër, ekzekutivi mund të përdorë vazhdimisht arsyetimin e llojit, pse do të ndanim më shumë nëse nuk shpenzohet edhe ato që janë ndarë. Shembuj të tillë kemi pasur deri më tani, veçanërisht në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve (e cila i menaxhon paratë nga programi i gjithëpërfshirjes në fushën e infrastrukturës dhe strehimit) dhe në Ministrinë e Shëndetësisë (e cila i menaxhon paratë në këtë fushë dhe të cilat kryesisht shkojnë për asistentët shëndetësorë).

Eksperti konsideron gjithashtu se koncepti i asistentëve arsimorë apo shëndetësorë është i gabuar dhe se do të ishte shumë më e dobishme nëse më shumë romë do të punësoheshin në institucionet arsimore apo shëndetësore. Në këtë mënyrë, sipas ekspertit, romët do të kenë më shumë besim tek institucionet, një nga arsytet pse ka problem me përdorimin e shërbimeve të këtyre institucioneve nga romët.

Rezultatet më të mira janë arritur në arsim dhe politika është ende duke u zbatuar në mënyrë që gjithëpërfshirja të jetë e suksesshme dhe të japë rezultate. Sipas ekspertit, probleme ka pasur edhe në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve. Deri më tani, sipas ekspertit, paratë janë shpërndarë edhe mes "katër syve" në fund të vitit. Tani ka kriterë shumë më serioze se si shpallet dhe zbatohet tenderi publik për shfrytëzimin e atyre parave përmes realizimit të projekteve, sqaron eksperti. Aty, megjithatë, problemi kryesor për momentin është se ka komuna që ose nuk janë të interesuara t'i plotësojnë kushtet teknike për marrjen e parave (kryesisht ankohen se nuk kanë kapacitete në administratën e pushtetit lokal për t'i përgatitur dokumentet) ose nga ana tjetër atë e përdorin si justifikim dhe nuk janë të interesuar t'i zgjidhin problemet e infrastrukturës së getove romë. Ndonëse ka pasur edhe raste të kundërshtimeve nga komunitetet jo-romë kur në komuna të caktuara duhet të caktoheshin njësi banimi (shtëpi apo ndërtesa tipike), të dedikuara për zgjidhjen e problemit të strehimit me të cilin përballen romët, të cilat, nga këndvështrimi i ekspertëve, mund të etiketohen edhe si racizëm.

Si do që të jetë, paratë prej një milion eurosh në vit nuk mjaftojnë, pohojnë bashkëbiseduesit tanë, të cilët ndihmuan në përpilimin e këtij raporti.

GJUHA E URREJTJES ËSHTË VAZHDIMISHT NË RRIJTJE - MOSNDËSHKIMI ËSHTË ARSYEJA KRYESORE

Problemi me gjuhën e urrejtjes në RMV mbetet ose, më saktë, po bëhet problem gjithnjë e më i madh, me të cilin shoqëria në tërësi nuk mund të gjejë përgjigje efektive për momentin. Ndonëse është vërejtur si problem dhe ka filluar të monitorohet para më shumë se dhjetë vjet, megjithëse janë ndërmarrë masa më aktive dhe më shumë iniciativa, fillimisht nga sektori joqeveritar, e më

pas edhe nga shteti, i cili e inkorporoi atë si vepër penale në disa nene të legjislacionit penal, edhe pse organet e hetuesisë, prokuroria dhe organet gjyqësore tashmë janë trajnuar dhe bëjnë përpjekje për të trajtuar gjuhën e urrejtjes - rezultatet mungojnë. Më saktë, nga biseda me të gjithë ekspertët që merren me këtë çështje, mund të vlerësohet se ato madje edhe përkeqësohen.

Përshtypja se ka përkeqësim vjen, në radhë të parë, nga treguesit statistikorë. Numri i rasteve të gjuhës së urrejtjes po rritet nga viti në vit, kurse një rritje drastike, prej madje 160 për qind, është regjistruar nga organizatat joqeveritare në kalimin nga viti 2019 në vitin 2020, në fillim të pandemisë së Kovid-19, dhe ky trend nuk po ndalet, gjegjësisht është duke u regjistruar edhe sot. Ilustruese janë të dhënat që i morëm nga ekspertët e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut se nga viti 2014 deri më 1.6.2022 janë regjistruar **3.046 raste të gjuhës së urrejtjes**. Regjistrimi i këtyre rasteve mund të shihet në platformën online për raportimin e gjuhës së urrejtjes, e cila është krijuar në vitin 2014 nga KHDNJ-ja, me ndihmën e NED-it amerikan, “Gjuha e urrejtjes” (govornaomraza.mk), e cila është aktive prej gati 10 vitesh. Që nga viti 2018, KHDNJ-ja merret në mënyrë sistematike, analitike dhe praktike me gjuhën e urrejtjes dhe mënyrat e regjistrimit, parandalimit të saj, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimin të publikut për seriozitetin e problemit. Ato 3.046 raste që janë regjistruar që atëherë janë raste të pastra të gjuhës së urrejtjes mbi 14 baza të ndryshme, të cilat njihen edhe me ligj, dhe vlen të theksohet se janë kontrolluar dhe filtruar nga numri i raportimeve, që është shumë më i madh, gjegjësisht nuk ka dyshim se bëhet fjalë për gjuhë të urrejtjes.

Si baza më të zakonshme për gjuhën e urrejtjes nga kjo statistikë veçohen **përkatësia etnike - me 1.477 raste ose 37 për qind, përkatësia politike - me 922 raste ose 23 për qind, përkatësia seksuale ose gjinore - me 901 raste ose 23 për qind, seksi dhe gjinia - me 238 raste ose 6 për qind**.

Gjuha e urrejtjes mund të gjendet kudo, por platformat më të zakonshme për përhapjen e saj janë rrjetet sociale. Nëse renditen nga ekspertët, më së paku haset në mediat tradicionale, shumë më tepër në mediat online, por padyshim si platforma “mbjellëse” të gjuhës së urrejtjes keqpërdoren “Facebook”, “Youtube” dhe së fundmi edhe “Tik-tok”.

Statistikat, si kjo në platformën e specializuar, i konfirmojnë edhe baza të tjera të dhënash nga sektori joqeveritar ose nga ana tjetër, shifrat që i kanë edhe institucionet zyrtare, duke përfshirë edhe statistikën e mbajtura nga Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Sipas kërimit statistikor në faqen e KPMD-së, vetëm nga viti 2021 deri në janar të vitit 2022, Komisioni ka marrë 14 vendime për një formë të kryer të diskriminimit nëpërmjet gjuhës së urrejtjes ose gjuhës shqetësuese të shprehur përmes mjeteve të informimit publik/mediave, e kryesisht përmes rrjeteve sociale “Facebook” dhe “Twitter”. Një fjalim i tillë u drejtohej personave që i përkasin një grupi të marginalizuar, dhe i referohen orientimit seksual, gjegjësisht në bazë të seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor. Në bazë të prejardhjes kombëtare apo etnike, origjinës, aftësisë së kufizuar, gjendjes familjare apo martesore e të tjera, janë konstatuar edhe shtatë raste të tjera ku është konstatuar gjuhë shqetësuese apo diskriminuese, kështu që në total ka mbi **20 raste të tilla për vitin 2021**, vetëm nëpërmjet mjeteve të informimit publik/mediave, ku bëjnë pjesë edhe rrjetet sociale. Nëse merren parasysh edhe mënyrat e tjera të shprehjes së gjuhës së urrejtjes, është shumë i qartë raporti kur krahasohet numri i përgjithshëm i vendimeve dhe i mendimeve të marra nga Komisioni. Komisioni përcaktoi se në këto 20 raste si diskriminues paraqiten personat fizikë, një shoqatë e qytetarëve, portalet e internetit, si dhe personat që janë redaktorë dhe regjistruar të portaleve të internetit. Por, numri rritet në mënyrë dramatike në vitin 2022, andaj Komisioni në raportin e tij tremujor për periudhën janar-mars 2022 paraqet informatën se deri në 50 për qind të parashtrësive ku është konstatuar diskriminim, gjegjësisht **13 parashtrësia**, i referohen diskriminimit të kryer përmes mjeteve të informimit publik/mediave, ndërsa numri më i madh i tyre i referohet rrjetit social “Facebook”, përmes të cilit është përcaktuar ngacmimi apo thirrja, nxitja dhe udhëzimi për diskriminim përmes publikimit të përmbajtjeve diskriminuese. Përveç në “Facebook”, kjo lloj gjuhe dhe përmbajtje është zbuluar edhe në “YouTube”, “Twitter” dhe te një portal interneti.⁴⁰

Nëse i marrim parasysh rastet e regjistruara nga shoqatat e gazetarëve në një ose dy vitet e fundit dhe organizata të tjera joqeveritare (për shembull, vetëm “Metamorfozis” ka regjistruar rreth dhjetë raste të gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes së krimeve të urrejtjes ndaj punonjësve të saj), është mjaft e qartë madhësia e problemit me të cilin përballlet shoqëria.

40 KPMD – Prill 2022– Raporti tremujor– fq. 12 - (në dispozicion në <https://bit.ly/3aArNol>)

Sipas ekspertëve të KHDNJ-së, një nga problemet më urgjente është se nuk ka ndëshkim sistematik të gjuhës së urrejtjes. Ata, ashtu siç e zbulon edhe KE-ja në raportet e veta, theksojnë se shteti nuk ka një sistem ndëshkimi, megjithëse sektori joqeveritar ndihmon në zbulimin e tij, mbledhjen e provave, komunikimin mes Prokurorisë Publike dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, por në fund praktika gjyqësore i dëshmon shifrat dëshpëruese, sepse rastet për të cilat PP-ja ka nisur procedura për gjuhën e urrejtjes nëpër gjykata mund të numërohen në gishtat e njëjës dorë për vite të tëra. Meqenëse edhe shoqatat e gazetarëve, pas raportimeve të tyre për gjuhën e urrejtjes ndaj gazetarëve nga PP-ja, bile dhe gjykatat shpesh japin një justifikim se nuk ka prokurorë dhe gjyqtarë të trajnuar që do të merreshin me këtë problem, KHDNJ-ja me ndihmën e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorët dhe me mbështetjen e OSBE-së, në vitin 2021 organizuan trajnime për prokurorë dhe gjyqtarë nëpër të cilat kaluan 60 pjesëmarrës, ndërsa me pjesëtarët e Sektorit përkatës të Punëve të Brendshme për forenzikë dhe krim kompjuterik trajnimet e organizuara ishin pak më komplekse, gjegjësisht nëpër njësitë rajonale në çdo sektor rajonal në vend.

NEVOJITEN NDRYSHIMET NË KORNIZËN LIGJORE

Si një nga mënyrat për të trajtuar në mënyrë më efektive fenomenin e gjuhës së urrejtjes, ekspertët rekomandojnë se duhet menduar në mënyrë sistematike për ndryshimet në kornizën ligjore për zgjidhjen e problemit.

Në fakt, ata pajtohen se edhe Kodi Penal aktual, i cili në pesë nene zbulon dhe parasheh sanksione për gjuhën e urrejtjes mbi baza të ndryshme, e mbulon këtë çështje relativisht mirë, megjithëse nuk përjashtojnë që ndoshta edhe këtu mund të shtohen nene të reja me të cilat do të përforcohej mbulimi i gjuhës së ndryshme të urrejtjes. Por, si problem ata i theksojnë mijëra shembujt e gjuhës së urrejtjes apo të gjuhës kufitare, e cila përveç diskriminimit mund të shkaktojë në vazhdimësi edhe krime të urrejtjes, të cilat janë të vështira për t'u ndjekur penalisht. Për shembull, komentet në "Facebook" nën postimet e bartësit të profilin dhe shembujt të ngjashëm në rrjetet e tjera sociale. Në atë drejtim, ekspertët rekomandojnë të mendohet për forcimin e përgjegjësisë kundërvajtëse, gjegjësisht të ndërhyhet në Ligjin për Kundërvajtje, dhe si një nga masat që mund të ndihmojë është dhënia e autorizimit që disa institucione të kenë edhe rol kundërvajtës, gjegjësisht të shqiptojnë dënime për kundërvajtje. Si shembull ata e përmendën Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, anëtarët e të cilit, për qëllime të këtij raporti, vetë theksuan se po mendojnë në atë drejtim dhe do të ndërmarrin iniciativë për të pasur një autorizim të tillë. Sepse, siç thonë ekspertët, është shumë e rëndësishme që individit, qoftë edhe me një gjobë minimale, të ndjejë se gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi që e bën në atë mënyrë është sjellje e papranueshme.

Përndryshe, mosndëshkimi krijon shumëzim dhe kthim, gjegjësisht i njëjti autor i gjuhës së urrejtjes, i cili njëherë është sanksionuar në një farë mënyre, të kthehet dhe ta përsërisë veprën. Një shembull i tillë është paraqitur në lidhje me një rast që ka kaluar në KPMD. Komisioni lëshoi mendim dhe kërkoi nga autori që ta hiqte përmbajtjen nga "YouTube", ai e bëri këtë, por vetëm përkohësisht, pas së cilës e ktheu përmbajtjen kontroverse në të cilën u zbulua gjuha e urrejtjes ndaj figurave të ndryshme publike nga sfera të ndryshme të shoqërisë.

Përveç kësaj, ekspertët theksojnë se një problem që e mundon shoqërinë, i cili është afër gjuhës së urrejtjes, është bullizmi kibernetik. Ata theksojnë se në legjislacionin e RMV-së as që është përcaktuar kjo çështje, e lëre më të flitet për trajtimin e saj.

POLITIKANËT SI NXITËS TË GJUHËS SË URREJTJES

Në një bisedë me ekspertët për përshtypjen e tyre për vullnetin politik të aktorëve kryesorë në jetën politike të vendit për t'u përballur me gjuhën e urrejtjes, ata theksojnë se nuk mund të zbulohet asnjë interesim apo vullnet i fortë politik. Arsyeja është e thjeshtë. Figurat politike të zgjedhura apo të emëruara, vetë partitë politike përmes komunikimit të tyre me publikun, shpesh regjistrohen si nxitës të gjuhës së urrejtjes. Këtë e tregojnë edhe statistikët. Gjuha e urrejtjes për shkak të përkatësisë politike është në katër kategoritë e para të gjuhës së urrejtjes që regjistrohet, më saktë në vendin e dytë, kurse si nxitës konsiderohet gjuha e politikanëve dhe partive para çdo zgjedhjeje apo vendimi të rëndësishëm politik, siç janë referendumet dhe debatet tjera në shoqëri.

Shpesh kjo gjuhë fshihet me mjeshtëri dhe nuk është gjuhë e pastër urrejtjeje, por është padyshim gjuhë nxitëse, e cila më pas prodhon gjuhë të urrejtjes në shoqëri. Më e rëndësishmja, ekspertët që e ndjekin problemin tregojnë se nuk ka pasur asnjë reagim nga vetë politikanët. Nuk ka asnjë dënim apo shprehje publike të mospajtimit me gjuhën e dikujt nga partitë amë, por edhe në përgjithësi. E ata, si bartës të funksioneve publike, do të duhej të jenë shumë më të përgjegjshëm dhe t'i nënshtrohen sanksioneve më të larta për komunikime të tilla të pahijshme në publik. Meqenëse problemi qëndron pjesërisht në imunitetin e politikanëve të zgjedhur, p.sh., deputetëve të Kuvendit të RMV-së, ku ka edhe shembuj të shumtë të gjuhës së afër me gjuhën e urrejtjes apo gjuhën diskriminuese, kryesisht për shkak të përkatësisë politike apo seksuale dhe gjinore, ekspertët rekomandojnë që një mënyrë e mirë për t'u përballur me të do të ishte zbatimi rigoroz i kodeve etike që i kanë institucionet, nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, si dhe administrata publike, dhe sigurisht vendosja e rregullave të brendshme etike në çdo parti politike ose lëvizje që merret me politikë.

Edhe një tjetër ekspert nga fokus grupi, të cilin e kemi konsultuar për reformat në media, mendon se elitat politike nuk janë të interesuara për zgjidhjen e problemit të gjuhës së urrejtjes. Ai thotë se ka përshtypjen se elitat politike e lënë qëllimisht këtë hapësirë të pambuluar me ndëshkimi si "hapësirë e lirë", sepse e përdorin masivisht kur u nevojitet, përmes mekanizmave të tyre të detajuar të "bot"-eve.

MOSNDËSHKIMI ÇON NË KRIM TË URREJTJES

Ajo që është më e frikshme është se është zbuluar se autorët dhe viktimat më të shpeshta të gjuhës së urrejtjes janë të rinjtë, gjegjësisht njerëzit e moshës deri në 26 vjet. Mosndëshkimi çon në shumëfishimin e gjuhës së urrejtjes, por edhe në krimin e urrejtjes. Sipas statistikave të KHD-NJ-së, por edhe të organizatave të tjera, gjuha e urrejtjes pasohet nga krimi i urrejtjes. Që nga viti 2014, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka monitoruar në mënyrë sistematike fenomenin e krimeve të urrejtjes përmes ueb-faqes së saj të specializuar [Krimet e urrejtjes](#). Të dhënat për vitin 2021 janë ende duke u sistemuar dhe analizuar. Megjithatë, se sa i madhë është problemi i krimit të urrejtjes së nxitur nga gjuha e urrejtjes, gjithsesi flasin të dhënat nga Raporti Vjetor për vitin 2020, ku thuhet:

"Komiteti regjistroi dhe publikoi 104 krime/incidente të urrejtjes për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2020. Rënia e dukshme e incidenteve të regjistruara (104) krahasuar me vitin 2019 (159), ka të ngjarë të lidhet me rrethanat e jashtëzakonshme të shkaktuara nga pandemia dhe orët e shumta policore të vendosura gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, për të cilën gjë do të flasim më në detaje në pasqyrën e gjetjeve kryesore."

Një vështrim në hartën interaktive të portalit tregon se ky numër është i lartë edhe për vitin 2021, andaj mund të vlerësohet definitivisht se gjuha e urrejtjes, e cila çon në krim të urrejtjes, është një fenomen me tendencë përkeqësimi dhe se shteti duhet të marrë masa për t'u përballur me problemin.

Fondacioni “Metamorfozis” - Monitorimi i procesit të eurointegritimeve

Përmbledhje e shkurtër e shkallës së reformave në tre fusha: gjyqësori, sektori i mediave dhe administrata publike në periudhën mars – qershor 2022

REFORMAT NË DREJTËSI NË PERIUDHËN 31.3 DERI MË 30.6.2022

Procesi i reformës në fushën e drejtësisë në periudhën që po raportojmë ka pak elementë që mund të cilësohen si pozitivë apo progres në këtë fushë.

Për sa i përket legjislacionit dhe qasjes strategjike, mund të thuhet se vazhdon puna për një ligj krejtësisht të ri për procedurën penale dhe Kodi të ri Penal, për të cilin grupet punuese në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë janë ende duke punuar. Puna është duke u bërë në grupe pune dhe versionet përfundimtare mund të priten në fund të vitit 2022, thonë ekspertët që u konsultuan. Tashmë kanë përfunduar përgatitjet për Ligjin e ri për Ekspertizën, i cili pritet të rrisë efikasitetin e procedurave gjyqësore, por ende nuk është dërguar në Qeveri për shqyrtim. Një nga ndryshimet në këtë ligj parashikonte edhe heqjen e Byrosë së deritanishme për Ekspertizë Mjeko-Ligjore dhe shndërrimin e saj në Agjenci për Ekspertizë Mjeko-Ligjore, por kjo varet edhe nga procesi aktual i riorganizimit të organeve të administratës shtetërore. Për sa i përket dokumentit kyç, Strategjisë për Reformat në Drejtësi, siç thekson edhe vetë Këshilli Gjyqësor, është e nevojshme të rikonfirmohet puna e Këshillit për Reformat në Drejtësi, i cili duhet të punojë në strategjinë e re, sepse ajo ekzistuese skadon gjatë vitit 2022. Ekspertët nuk janë në dijeni nëse kjo do të bëhet me riaktivizimin e Këshillit për Reformat, por konfirmojnë se janë dërguar ftesa për aktorë të ndryshëm për përfshirje në punën për përgatitjen e dokumentit të ri të Strategjisë 2023 - 2027.

Kur bëhet fjalë për gjyqësorin, pak elementë në drejtim pozitiv mund të konstatohen në drejtim të sigurimit të pavarësisë, përgjegjësisë së gjyqtarëve, efikasitetit të gjykatave dhe sigurimit të pavarësisë financiare.

Nga ajo që është e re dhe është zbatuar në mënyrë efektive që nga ky vit, megjithëse është miratuar vitin e kaluar, mund të vihet në pah aplikimi i Metodologjisë me tregues për përcaktimin e kompleksitetit të lëndëve, si dhe Rregullorja për mënyrën e formimit të komisioneve për vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave. Dy aktet e Këshillit Gjyqësor janë përcaktuar dhe miratuar në fund të shtatorit të vitit të kaluar dhe pritet që në vitin 2022 të ndihmojnë veçanërisht në dy proceset që janë vendimtare për vlerësimin e efikasitetit të gjykatave dhe vlerësimin e punës së vetë gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, prej të cilës varet edhe ngritja në detyrë ose shkarkimi i gjyqtarëve.

Kur bëhet fjalë për përcaktimin e punës së vetë gjyqtarëve, rritet numri i gjyqtarëve për të cilët diskutohet pas parashitësive të pranuar dhe numrit të gjyqtarëve të shkarkuar. Gjatë vitit 2021, shtatë gjyqtarë u shkarkuan, disa pas procedurave të nisura qysh në vitin 2018, ndërsa vlerësimi i përgjegjësisë është në pritje për 49 gjyqtarë në 25 procedura të iniciuara për përcaktimin e përgjegjësisë (Burimi: Këshilli Gjyqësor i RMV-së).

Për sa i përket efikasitetit, mund të konstatohet se nuk ka lëvizje përpara, sepse sipas vlerësimit të vetë Këshillit Gjyqësor në [Raportin vjetor për Kuvendin e RMV-së](#) të dorëzuar në muajin mars dhe që ende nuk është marrë në shqyrtim nga deputetët, thuhet se 15 gjykata janë vlerësuar si të shpejta në punë në vitin 2021, kurse 19 gjykata janë vlerësuar si jo të shpejta në punë, megjithëse nëse shikohet numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura në periudhën gjatë të gjithë vitit 2021, rezulton se numri i lëndëve të pazgjidhura është reduktuar për mbi 2.256 lëndë. Por, që pasqyra të jetë e plotë, duhet pasur parasysh se numri i lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura prej vitesh është mbi 90.000 lëndë. Sa i përket efikasitetit, një kërcënim i madh është se vazhdon trendi i uljes së numrit të gjyqtarëve, i shumëzuar me kërcënimin se me ndryshimet në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës, dhjetëra gjyqtarë (59 gjyqtarë dhe 13 prokurorë) do të duhet të dalin në pension nga 1.7.2022 për shkak të moshës prej 64 vjeç. Për tejkalimin e këtij problemi, Qeveria më 22.6.2022 ka dorëzuar në Kuvend [Ndryshime urgjente në LMP](#), me të cilin gjyqtarët dhe prokurorët do të lejohet ta zgjasin përkohësisht mandatin e tyre edhe për tre vite të tjera deri sa të arrijë gjenerata e re nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Në fund të muajit qershor këto ndryshime u vunë në rendin e ditës para organeve parlamentare dhe u zhvillua diskutimi në një nga komisionet

parlamentare edhe [me një incident fizik](#), pasi deputetët e opozitës e kundërshtuan këtë mënyrë të miratimit të ligjit dhe propozuan midis 200 deri në 300 amendamente, me qëllim që ndryshime në LMP të mos kalojnë deri në afatin e fundit, 30.6.2022. Deri në përfundimin e këtij raporti në ditën e fundit të qershorit, ndryshimet në ligj nuk ishin miratuar nga Kuvendi, kështu që mund të konstatohet se problemi i efikasitetit si në gjyqësor ashtu edhe në prokurori do të intensifikohet realisht në muajt në vijim.

Një nga “dhimbjet” kryesore në gjyqësor është sigurimi i pavarësisë reale financiare, kundrejt asaj të deklaruar, sepse pushteti gjyqësor është ende larg përqindjes së garantuar me ligj prej 0.8 për qind të PPB-së së realizuar një vit më parë dhe është rreth 0.3. për qind, sipas deklaratës së Këshillit Gjyqësor në Raportin Vjetor për vitin 2021.

SHTETI ME MË SHUMË PARA PËR GJYQËSORIN DHE PROKURORINË, “ME LUGË”

Në fakt, gjyqësori vitin e kaluar e përfundoi me 2,07 miliardë denarë të shpenzuara ose **33.6 milionë euro**, ku dominues, me rreth 80 për qind, ndërsa shpenzimet për rroga dhe kompensime për rrogat, ndërsa zëri për pajisje materiale me mallra dhe shërbime ka marrë pjesë me një masë shumë modeste prej 14 për qind të shumës totale dhe me përqindje minimale për shpenzimet kapitale.

Për vitin 2022, shteti me rebalancin në Kuvend, projektin që gjyqësori të ketë në dispozicion 2,36 miliardë denarë, ose **gati 38 milionë euro**, ndërsa shpenzimet nga buxheti themelor mbeten në 2,18 miliardë denarë ose **35.4 milionë euro**, ndërsa mjetet e mbetura janë nga aktivitetet vetë-financuese dhe donacionet.

Financimi mbetet problem edhe për Prokurorinë Publike (PP), sepse as atje nuk respektohet detyrimi ligjor për financim me 0,4 për qind të buxhetit për vitin aktual. Vitin e kaluar e PP-ja e RMV-së kishte në dispozicion një buxhet prej mbi 574 milionë denarë ose **rreth 9,3 milionë euro**. Për këtë vit ai buxhet ishte paraparë të rritet në 662 milionë denarë, ndërsa me rebalancin që është në Kuvend është zvogëluar për rreth 20 milionë, kështu që shuma e përgjithshme që e parasheh shteti është rreth 642 milionë denarë **ose rreth 10,4 milionë euro**, që është një rritje e lehtë prej një milion eurosh krahasuar me vitin 2021, por është ende larg mbi 15 milionë eurove të kërkuara nga PP-ja.

TRANSPARENCA MUND TË ZMBRAPSET

Transparenca në gjyqësor, mbi të gjitha, në fushën e komunikimit me publikun, që është një nga faktorët kyç për perceptimin e punës së Prokurorisë Publike dhe të pushtetit gjyqësor, në përgjithësi, është në një nivel më të lartë krahasuar me disa vite më parë. Në të njëjtën kohë, perceptimi i kësaj transparence mbetet në të njëjtin nivel të vlerësimit nga raportet e mëparshme të Fondacionit “Metamorfozis” për periudhën korrik 2021 deri në korrik të vitit 2022: Gjyqësori ka arritur pak më shumë në rritjen e transparencës, ndërsa sistemi i Prokurorisë Publike mbetet, si të thuash, i ngecur në vend dhe ato përpjime të vogla që i ka arritur për sa i përket hapjes, shpeshherë i anulon me vendime të diskutueshme. Në këtë raport, ndajmë pak më shumë hapësirë për shkak të vlerësimit të një eksperti nga fokus grupi se gjërat janë ndalur në një moment të progresit dhe mund të shkojnë prapa.

-Kam ndjesinë se në aspektin e transparencës edhe gjyqësori edhe prokuroria po bëjnë dy hapa përpara, tre hapa prapa – thotë një ekspert që e konsultuam për këtë çështje.

Të numëruara saktësisht, pluse mund të marrë ende Këshilli Gjyqësor, organi suprem i pushtetit gjyqësor, sepse mbetet konstatimi se ai njofton në kohë seancat e Këshillit Gjyqësor, mundëson prezencë të publikut në seanca dhe më pas i publikon rregullisht konkluzionet e seancave. Sa i përket gjykatave, kjo varet nga gjykata në gjykatë, thotë eksperti. Në shumicën e gjykatave, gjyqtarët e emëruar janë zëdhënës të gjykatave. Edhe këtu situata varet nga personi në person, nga kuptimi i atij gjyqtari-zëdhënës, si dhe nga kryetari i gjykatës për rëndësinë e komunikimit me publikun, por këtu ka edhe një dobësi shtesë, sepse ata gjyqtarë-zëdhënës. gjithashtu kanë punë të rregullt gjyqësore dhe nuk kanë gjithmonë kohë dhe sens për t’iu përkushtuar ndonjë çështjeje aktuale publike.

Sa i përket Prokurorisë Publike, organi suprem i saj, Këshilli i Prokurorëve Publikë, mbetet me vlerësimin i mbyllur dhe jo mjaftueshëm transparent. Përmirësimi i vogël që është bërë me një ueb-faqe më transparente është mohuar nga mbyllja e mëtejshme e seancave për publikun për shkak të pretendimit të mungesës së hapësirës dhe “shqetësimit” që e ndajnë anëtarët e Këshillit në lidhje me praninë e kamerave në seancat e tyre. Po ashtu, publikimi i procesverbaleve të detajuara të seancave pas mbajtjes së tyre tashmë ka bërë një hap prapa, duke i anonimizuar emrat e anëtarëve që kanë folur dhe nuk dihet se cili nga anëtarët çfarë mendimi ka pasur.

I njëjti vlerësim për mbylljen gjysmake mbetet edhe për sistemin e Prokurorisë Publike. Ka zëdhënës që po t’u bësh një pyetje pret, ndonjëherë edhe një ose dy ditë, sepse për përgjigjen duhet të konsultohen me njerëzit e parë të Prokurorisë, shpesh ato përgjigje janë teknike dhe jo thelbësore dhe krijohet përshtypja se në fund gjithçka varet nga personi që zgjidhet për kryetar të njëjës prej prokurorive, ose më saktë, e gjithë transparenca në masë të madhe varet nga zgjedhja e prokurorit publik të shtetit, vlerëson eksperti nga fokus grupi. Duke e shpjeguar mendimin e tij, ai thekson se të vetmin hap përpara në komunikim me publikun e kanë arritur Prokuroria për Krim të Organizuar dhe Korrupsion dhe Prokuroria Publike e Shkupit.

Kjo gjendje “as në tokë as në qiell” për sa i përket transparencës duket se është pasqyruar edhe në Ministrinë e Drejtësisë, e cila prej disa kohësh përmes një grupi pune po e përgatit Strategjinë për Transparencë në Gjyqësor. Sipas informacioneve të marra gjatë përgatitjes së këtij raporti, puna ka ngecur prej disa kohësh, pasi disa muaj më parë një grup gazetarësh, kryesisht të përfshirë në punën e Këshillit Gjyqësor-Mediatik, bënë kërkesa për të hyrë në Strategji për ndryshime në disa ligje kyçe nga gjyqësori ku vendosen norma për transparencën e gjykatave, para së gjithash në Rregulloren e punës së gjykatës, i cili është mjaft i vjetruar. Problemi që e veçon eksperti është disponueshmëria e procesverbaleve nga seancat gjyqësore, të cilat janë të nevojshme që gazetarët të raportojnë më saktë për publikun. Edhe pse nuk ka asnjë pengesë ligjore që gazetarëve t’u jepen procesverbalet, ata megjithatë duhet të gjenden për t’i marrë ato përmes lidhjeve anësore, para së gjithash nga mbrojtja.

Një ngecje sikur ndihet në punën e Këshillit Gjyqësor-Mediatik, i cili për të katërtin vit me radhë po përpiqet të gjejë zgjidhje që do të ndihmonin në një transparencë më të madhe të gjyqësorit. Ky organ i përbërë nga gjyqtarë dhe gazetarë, sipas ekspertit, duket se ka ngecur mes dallimeve thelbësore të pritshmërive të të dyja palëve. Në fakt, gjyqtarët e perceptojnë atë si një lloj organi etik, gjë që nuk është kështu, dhe në përgjithësi, sipas ekspertit, ata janë të mendimit se gazetarët janë kryesisht fajtorë për faktin se perceptimi i publikut për besimin në gjyqësor është kaq i ulët.

- Ka gjyqtarë dhe prokurorë që e kuptojnë jashtëzakonisht mirë rolin e publikut dhe rëndësinë e transparencës për një perceptim më të mirë dhe më të saktë të publikut ndaj gjyqësorit, duke përfshirë edhe raportimin në media. Por, mund të them se megjithatë këto janë vetëm raste të veçanta. Shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë ende nuk e kuptojnë thelbin e transparencës. Prandaj, mendoj se para së gjithash është e nevojshme edhe në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, që kjo lëndë e transparencës të përfshihet shumë më seriozisht në procesin arsimor, të kenë trajnime, madje edhe ushtrime për konferenca për shtyp, sjellje përpara kamerës ose mikrofonit, e të ngjashme. Së dyti, duhet të ketë një ndryshim në ligjet kyçe që do ta saktësojnë dhe garantojnë transparencën, por në fund të fundit do të jetë e pashmangshme të pritët edhe ndërrimi i gjeneratave si të gjyqtarët ashtu edhe të prokurorët publikë, përfundon eksperti.

REFORMAT NË SEKTORIN MEDIATIK NË PERIU DHËN

31.3 DERI MË 30.6.2022.

Asgjë e re nuk ka ndodhur për sa i përket reformave në sektorin e mediave në periudhën që e vlerësojmë në lidhje me gjetjet e konstatuara tashmë në raportet tona të mëparshme.

I vetmi ndryshim i vogël vërehet në atë se Qeveria e RMV-së vendosi që procesin e dhënies së subvencioneve për mediat e shkruara ta bëjë më gjithëpërfshirës, kështu që në fund të qershorit mbajti një takim konsultativ në të cilin morën pjesë përfaqësues të palëve të interesuara, si dhe përfaqësues të shoqatave dhe organizatave profesionale të gazetarëve për atë se si të përmirësohet mënyra e ndarjes dhe kontrollit të fondeve të alokuara për mediat e shkruara. Pas 50 milionë denarëve fillestarë në vitin 2018, pastaj rënies prej rreth 20 milionë denarëve në tri vitet

e ardhshme për shkak të pandemisë dhe krizës, por edhe subvencionimit shtesë për vitin e parë pandemik 2020, të paguara në vitin 2021, për vitin 2022 me rebalancin e buxhetit për këtë qëllim janë paraparë vetëm 10 milionë denarë ose **rreth 162 mijë euro**.

VAZHDON MOSNDËSHKIMI PËR SULMET NDAJ GAZETARËVE

Kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve mbeten problem në vend. Në mars të këtij viti, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë doli me një publikim-analizë [“Sulmet ndaj gazetarëve apo punonjësve mediatikë 2017-2021, tendenca dhe rekomandime”](#), ku janë regjistruar 47 raste të sulmeve të ndryshme verbale apo fizike për periudhën e shënuar pesëvjeçare. Në analizë janë identifikuar disa tendenca, duke përfshirë se numri i sulmeve ndaj gazetarëve po rritet në vitin 2021. Por, një nga tendencat dhe përfundimet më të rëndësishme të SHGM-së në analizë është problemi i mosndëshkimit për këto sulme:

“Tendenca e katërt dhe ndoshta më e rëndësishme që ka ndodhur në dhjetë vitet e fundit është tendenca e mosndëshkimit të sulmeve ndaj gazetarëve. Përkundër raporteve të shumta vendore dhe ndërkombëtare që flasin për këtë problem, pavarësisht konferencave të shumta për të vënë në dukje këtë problem, dhe përkundër analizave dhe publikimeve të shumta për këtë temë, problemi i mosndëshkimit vazhdon të ekzistojë dhe të përmendet si shembull negativ në suaza botërore”.

Më shumë për vetë analizën dhe veçanërisht për mosndëshkimin mund të lexoni në tekstin e “Vërtetmatës”-it - [“Organet hetuese heshtin para sulmeve ndaj punonjësve mediatikë, caku më i shpeshtë janë gazetarët”](#). Në këtë kontekst, duhet theksuar se për këtë trend të mosndëshkimit apo rritjes së sulmeve ndaj gazetarëve kontribuon edhe në fakti se edhe pas gati një viti, Kuvendi nuk ka diskutuar për ndryshimet e propozuara në Kodin Penal, në të cilin, sipas propozimit të qeverisë, janë vendosur vepra të reja penale, me të cilat sulmi verbal apo fizik ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë do të trajtohet në mënyrë të barabartë sikurse edhe sulmi ndaj personave zyrtarë, të cilat ndiqen në mënyrë automatike nga Prokuroria Publike.

Situata me reformat në sektorin e mediave mbetet e mbërthyer edhe në segmente të tjera të rëndësishme. I pari dhe më i rëndësishmi është se përkundër dy përbërjeve parlamentare dhe përkundër dy konkurseve të shpallura, Kuvendi mbetet i shurdhër ndaj zbatimit të ndryshimeve në Ligjin për Shërbime Audio-Vizuale Mediatike, me të cilat duhet të mbahen zgjedhje të reja për anëtarët Agjencisë së mediave (ASHAAM) dhe Këshillit të ri Programor të RTM-së. Kjo situatë, pa dyshim, nga cilido ekspert i konsultuar për këtë raport, interpretohet si mungesë e vullnetit politik për reforma, megjithëse në deklaratat shumë të rralla të politikanëve nga partitë kryesore do të dëgjoni një justifikim se këto zgjedhje janë të vështira për t'u zbatuar sepse për to nevojitet shumicë prej dy të tretave në Kuvend.

TRANSMETUESI PUBLIK ENDE JASHTË PRIORITETEVE TË QEVERISË

Kjo, nga ana tjetër, çon në një problem tjetër që ekziston prej vitesh – MTV-ja e pareformuar, gjegjësisht një transmetues publik i pareformuar. Sipas një eksperti të fokus grupit, këtë e tregon tendenca e politikës për t'i lënë gjërat ashtu siç janë, pasi, sipas tij, mbetet kuptimi konservator dhe vulgar i politikanëve se pas fitimit të pushtetit ata marrin gjithçka, duke përfshirë edhe transmetuesin publik, të cilin ata e kuptojnë si transmetues shtetëror.

- Të gjitha elitat politike nga vitet '90-ta e tutje nuk patën guximin për ta shndërruar transmetuesin shtetëror në transmetues publik, e kjo është me rëndësi të jashtëzakonshme për demokracinë dhe për situatat e tjera në një shoqëri multikulturore dhe multietnike, siç është Maqedonia e Veriut - thotë eksperti. Në ndërkohë, ka tentativa për të ofruar një program të tillë nga disa televizione komerciale siç janë TV 21 apo TV “Alsat-M”, por kjo nuk është as obligim e as detyrë e tyre, këtë duhet ta bëjë TVM-ja. Ruajtja e demokracisë së brishtë bëhet me një program të ri cilësor, dhe nuk është e mundur pa zgjedhjen e Këshillit të ri Programor - thotë një ekspert i fokus grupit.

Plogështia e elitave politike ndaj transformimit të transmetuesit publik shihet edhe përmes fi-

nancimit. Ai mbetet në minimum, ndonëse ligji parashikon(te) që në vitin 2021 financimi të jetë në masën 75 për qind nga 1 për qind e buxhetit të shtetit një vit më parë. Në vend të kësaj, edhe pse buxheti tashmë ka arritur rreth 4 miliardë euro vitin e kaluar, financimi nuk ka lëvizur më shumë se 13-14 milionë euro, që sipas [Raportit vjetor të RTM-së për vitin 2021](#), krijon probleme në funksionim, aq më tepër që këstet mujore nuk janë paguar në mënyrë të barabartë gjatë gjithë vitit. TVM-ja po përballët me reduktim të stafit, teknologji të vjetëruar dhe një proces të ngadaltë digjitalizimi, megjithëse nevojat janë në rritje, sepse në vitin 2020 u hapën shërbime të reja programore, kurse programi në gjuhën shqipe transmetohet 24 orë në ditë.

- Ka edhe një arsye tjetër për këtë sjellje me përtesë ndaj financave. Këta janë transmetuesit komercialë në nivel kombëtar. Ata e dinë se me rritjen e financimit, mund të ndodhë një rritje e rrogave të gazetarëve dhe punonjësve të medias në RTM, kështu që pas dy dekadash do të ishim dëshmitarë të një procesi të kundërt - largimit të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë nga stacionet televizive private në transmetuesin publik. Prandaj, ata ushtrojnë presion të vazhdueshëm diskret ndaj partive në pushtet që të mos i japin më shumë para transmetuesit publik – thotë eksperti me të cilin biseduam.

Në sektorin e mediave, mbetet i pazgjidhur edhe problemi i financimit të mediave private me para publike. Përveç mediave të shkruara, të cilat subvencionohen me para publike, mbetet edhe një fluks i parave publike për mediat përmes proceseve zgjedhore, me ç'rast për çdo zgjedhje prej 3 deri në 5 milionë euro u jepen mediave për monitorimin e procesit zgjedhor, që sipas Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Korrupsionit që nga viti 2020, është një proces që mbart një rrezik të lartë të korrupsionit të mediave nga politika. Nga ana tjetër, vetë mediat vijnë me presionin për heqjen e ndalimit të reklamimit të punës së qeverisë dhe të institucioneve në sektorin publik, gjë që u arrit pas shumë vitesh lobimi nga shoqatat e gazetarëve në vitin 2017 dhe 2018.

REFORMAT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE NË PERIUdhËN 31.3 DERI MË 30.6.2022.

Pak gjëra kanë ndodhur në periudhën raportuese 31.3-30.6.2022 për sa i përket reformave në administratën publike, të cilat vërehen në këtë plotësim me informacione të reja në krahasim me raportin kryesor të Fondacionit “Metamorfozis” që u publikua në prill të këtij viti.

Sa i përket kornizës strategjike, pas fillimit të përgatitjeve para disa muajsh, Qeveria e RMV-së në mbledhjen e saj të 54 më 22.06.2022 e miratoi “Informacionin për përgatitjen e Strategjisë për RAP (2023-2030), me theks në rekomandimet e përfshira në raportin monitorues të SIGMA-s për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga viti 2021.

Në [njoftimin e shkurtër](#) vetëm thuhet se “në kuadër të procesit të vazhdueshëm të reformave në administratën publike dhe angazhimeve të forta në atë drejtim, synohet ofrimi i një administrate publike moderne dhe efikase të bazuar në digjitalizim, e cila ofron shërbime cilësore dhe të shpejta për qytetarët dhe subjektet afariste”.

Por fjalët “proces i vazhdueshëm i reformave... dhe angazhime të forta” nuk janë të përshtatshme kur bëhet fjalë për reformat ligjore, gjegjësisht për ndryshimet në ligjet kyçe që e rregullojnë administratën. Bëhet fjalë për ndryshimet në Ligjin për Nëpunësit Administrativ, ndryshimet në Ligjin për të Punësuarit në Sektorin Publik dhe Propozim-ligji për shërbimin e lartë menaxhues.

LIGJET ASSESI TË VIJNË NË KUVEND

Këto tre zgjidhje ligjore duhet të sigurojnë proceset e depolitizimit të administratës, veçanërisht në shërbimin e lartë menaxhues, proceset e administrimit më efikas, por edhe mënyrat për të vlerësuar dhe matur më mirë atë efikasitet, si dhe përmirësimin e rregullave të përgjithshme në sistemin e të punësuarve në sektorin publik. Edhe pse të tre dokumentet ligjore kanë kaluar të gjitha filtrat e mëparshëm, për sa i përket përgatitjeve, procesit konsultativ gjithëpërfshirës, konsultimeve përmes portalit qeveritar për dispozitat - ENER etj., ende nuk ka asnjë informacion nëse qeveria i ka shqyrtuar përgatitjet t'i përcjellë në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Nuk ka asnjë informacion të ri edhe për masën e zbatimit të riorganizimit të organeve të administratës shtetërore, për të cilën, gjithashtu, pas përgatitjeve dy-tre vjeçare janë bërë ndryshime

në ligjin përkatës - LOOASH. Gjithçka ka mbetur në konkluzionin e fundit të Qeverisë për të cilin njoftoi Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA) më 30.3.2022, se ky proces do të zbatohet përmes projekteve pilot në tri ministri – MSHIA, Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave dhe Ministrinë e Ekonomisë, të cilat me konkluzion të Qeverisë u ngarkuan që pas miratimit të ligjit të fillojnë me përgatitjet për zbatimin e organizimit të ri si ministri pilot.

Meqenëse Ministria për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, e cila u krijua me një zgjidhje ad-hoc në vitin 2019 me ndryshime në LOOASH-in e atëhershëm, nuk bën pjesë në tre ministrinë pilot të përmendura, mbetet e paqartë nëse, për shembull, në riorganizimin e Agjencisë për Rini dhe Sport, për të cilën ishte planifikuar të shfuqizohej dhe të bëhej sektor në Ministrinë për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, është një veprim i planifikuar në kuadër të gjithë riorganizimit apo bëhet fjalë për ndonjë zgjidhje më vete. Për planet e tilla [më 1 qershor Qeverisë i ka dërguar një protestë dhe letër të hapur](#) Këshilli Kombëtar Rinor i Maqedonisë, i cili, përkundrazi, kërkoi që Agjencia për Rini dhe Sport të rritet në një ministri të veçantë.

Ajo që rezultoi si konstatim i saktë nga raporti kryesor i Fondacionit “Metamorfozës” nga prilli është dobësia e sistemit për vlerësimin e administratës sipas rregullave në LNA, por edhe në përgjithësi, për vlerësimin e përgjithshëm të efikasitetit të punonjësve në sektorin publik. Në fakt, kjo doli në sipërfaqe pasi Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë hyri në negociata me Qeverinë, ndërsa në gjysmën e dytë të qershorit edhe në protesta dhe bllokada, sepse Qeveria nuk ka paraparë para në buxhet për vitin 2022 për rritjen e rrogave të punëtorëve në sektorin publik, në përputhje me detyrimin ligjor për t’u rritur brenda 6 muajve për shkak të respektimit të Ligjit për Rrogën Minimale. Në fakt, në komunikimin publik, edhe kryeministri dhe ministra të tjerë të qeverisë filluan të përmendin se problemi do të zgjidhet pasi të zhvillohet një metodologji e re për rrogat në sektorin publik, së bashku me një zgjidhje për matjen e efikasitetit të performancës së punonjësve në administratë dhe në sektorin publik dhe kjo duhet të rregullohet përmes Ligjit për Rroga. Një ekspert i grupit të fokusit që e konsultuam për këtë tha se dyshonte në sinjeritetin e deklaratës për sa i përket prapavijës.

- Motivi i vërtetë i një deklaratë të tillë është se shteti nuk ka para për një rritje të tillë, e jo për ndonjë metodologji apo model të ri të matjes së efikasitetit.

Teknikisht, rrogat dhe shuma e tyre dhe si do të rriten mund të zgjidhen ose duke i ndryshuar ligjet ekzistuese që e rregullojnë këtë çështje, domethënë LNA dhe LPSP, ose me një ligj qendror, që është Ligji për Rrogat, por edhe në këtë rast pastaj do të duhet të ndryshohen ligjet për administratë dhe sektorin publik në mënyrë që të jenë në përputhje me Ligjin e ri të Rrogave. Përndryshe, dhe deri më tani, përmes zgjidhjes ekzistuese ligjore, për shembull, në LNA, mund të matet efikasiteti i administratës, por siç thuhej edhe në raportin e Fondacionit “Metamorfozis” nga prilli, ai vlerësim bëhet vetëm formalisht.

TRANSPARENCA MBETET SEGMENTI MË I MIRË I REFORMAVE

Për sa i përket transparencës, nuk ka probleme apo ndryshime të mëdha. Ajo mbetet në kuadrin e asaj që thuhet se është më e mira e reformës së përgjithshme të administratës publike me të gjitha pikat e dobëta të renditura dhe nevojës për ushqyerjen e vazhdueshme të procesit të transparencës në të gjitha organet e administratës shtetërore dhe në të gjitha nivelet e pushtetit, si qendror ashtu edhe lokal, si legjislativ ashtu edhe gjyqësor.

Arritjet më të mëdha janë ende në transparencën financiare, gjegjësisht në aspekt të shpenzimit të parave publike, për të cilën gjë më meritore është ende zgjidhja përmes portalit qendror “Financat e hapura”. Progres i madh është arritur edhe përmes hapjes së të dhënave në portalin e përmendur, veçanërisht për vetëqeverisjen lokale, për të cilën gjë meritore ka edhe projekti i Fondacionit “Metamorfozis”, përmes të cilit nëpunësit e vetëqeverisjes lokale janë trajnuar për përshtatjen dhe përdorimin e portalit “Të dhënat e hapura”.

Për sa i përket hapjes dhe transparencës, dhe sipas matjes për vitin 2021, ajo mbetet e lartë, krahasuar me vendet e tjera të rajonit, e po ashtu i njëjtë është edhe raporti i koeficientëve në vetë qeverinë. Siç kuptohet jozyrtarisht, më e larta renditet Qeveria, pastaj Kuvendi, pastaj ministrinë, kurse një rënie e lehtë është vërejtur tek organet ekzekutive dhe administrative.

DIGJITALIZIMI ME SHPEJTËSINË E BRESHKËS

Për sa i përket digjitalizimit dhe shërbimeve elektronike, nuk ka ndryshime të mëdha. Procesi është i gjallë, por ecën përpara me një shpejtësi që nuk mund të vlerësohet si e kënaqshme. Ekspertët kanë përshtypjen se ndryshimet në këtë drejtim mund të ndodhin shumë më shpejt.

Kjo sigurisht që varet nga organizimi dhe paratë. Në fakt, ende nuk ka asnjë lajm për themelimin e Agjencisë Digjitale, e cila duhet t'i marrë përsipër detyrat kryesore në lidhje me digjitalizimin. Tani zhvillimi i shoqërisë informatike udhëhiqet nga MSHIA-ja, ndërsa në nivel qeveritar koordinohet nga zëvendës-kryeministrja përgjegjëse për politika të qeverisjes së mirë, Sllavica Gërkovska. Zhvillimi i digjitalizimit të përgjithshëm, në fakt, varet edhe nga vonesa e Strategjisë Kombëtare për TIK, e cila ka ngecur në ENER që nga korriku i vitit 2021, megjithëse konsultimet kanë përfunduar, por ende nuk është në rendin e ditës së Qeverisë.

Ende mbetet problemi me financimin e aktiviteteve të digjitalizimit. Duke i përfshirë edhe paqartësitë se sa para gjithsej janë ndarë për këtë. Nga ajo që mund të konstatohet nga rishikimi i buxhetit, më saktë nga rebalanci i dorëzuar në Kuvend në fund të majit, mund të shihet se për mbështetje informatike të Qeverisë janë ndarë 8,3 milionë euro, për shoqërinë informatike në kuadër të MSHIA-së gjithsej 7,75 milionë euro (këtu buxheti është rritur për më shumë se një milion euro), por në nënprogramin për zhvillim dhe zbatimin e TIK-ut në kuadër të MSHIA-së, që në fakt është shuma për digjitalizimin, ndërveprueshmërinë, rrjetëzimin e institucioneve mes tyre etj., shuma është 2,15 milionë euro.

Gjithashtu, tashmë janë ndarë 1,8 milionë euro dhe janë përdorur për lidhjen digjitale të 34 gjykatave në vend dhe bashkë me paratë për pajisjen digjitale të pesë gjykatave, të cilat janë kompletuar, shuma i kalon 2 milionë euro, duke i përfshirë këtu edhe disa qindra mijëra të marra nga donacione nga partnerë të huaj.

Në fund të muajit qershor, Fondacioni "Metamorfozis" organizoi një debat online në kuadër të projektit të saj ICEDA, për situatën aktuale në aspekt të digjitalizimit dhe drejtimit e ardhshme të veprimit, me ç'rast [u prezantua një raport gjithëpërfshirës](#) kushtuar ekskluzivisht digjitalizimit, dhe më pas u dhanë komente dhe rekomandime.

